



БЛУПРИНТ ГРУПА
за реформи во правосудството

ANALIZË E CILËSISË SË REFORMAVE QË KANË TË BËJNË ME ZGJEDHJEN, ZGJEDHJEN NË GJYKATË MË TË LARTË DHE SHKARKIMIN E GJYKATËSVE

SHKUP, 2020



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN OTBORENO
SOCIETY OPIШTECTBO
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

ANALIZË E CILËSISË SË REFORMAVE QË
KANË TË BËJNË ME ZGJEDHJEN,
ZGJEDHJEN NË GJYKATË MË TË LARTË DHE
SHKARKIMIN E GJYKATËSVE



Botues:

Koalicioni i shoqatave të qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë" - Shkup

Rreth botuesit:

Natali Petrovska – *drejtoreshë ekzekutive Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë*

Redaktor:

Ivana Petkovska

Autorë:

Natali Petrovska – *Koalicioni të gjithë për gjykim të drejtë*

Sibel Amet – *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë*

Ismail Kamberi – *Instituti për politikë evropiane*

Margarita Tsatsa Nikolovska - *Instituti për të drejtat e njeriut*

Maja Stojanoska - *Instituti për të drejtat e njeriut*

Goce Kocevski - *Shoqata maqedonase e juristëve të rinj*

Zharko Haxhi-Zafirov – *Qendra për Hulumtime Juridike dhe Analiza*

Përkthim:

Vjosa Taipi

Dizajni grafik:

Daniell Mitkovski

Shtypi:

Grafohartija

CIP - Каталогизacija во публикаcija

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.962.2/.3(497.7)"2017/19"(047.31)

ANALIZË e cilësisë së reformave që kanë të bëjnë me zgjedhjen, zgjedhjen në gjykatë më të lartë dhe shkarkimin e gjykatësve / [autorë Natali Petrovska ... и др.] - Shkup : Koalicioni i shoqatave të qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2020. - 44 стр. : илустр. ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Други автори: Natali Petrovska, Sibel Amet, Ismail Kamberi, Margarita Tsatsa Nikolovska, Maja Stojanoska, Goce Kocevski, Zharko Haxhi-Zafirov

ISBN 978-608-4552-44-4

1. Petrovska, Natali [автор] 2. Amet, Sibel [автор] 3. Kamberi, Ismail [автор] 4. Nikolovska, Margarita Tsatsa [автор] 5. Stojanoska, Maja [автор] 6. Kocevski, Goce [автор] 7. Haxhi-Zafirov, Zharko [автор] а) Судии - Избор и разрешување - Македонија - 2017-2019 - Истражувања

COBISS.MK-ID 112445194

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe grantuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Tabela e përmbajtjes

SHËNIME HYRËSE	1
Qëllimi dhe lënda e analizës	1
Metodologjia e përdorur	2
Struktura e analizës	3
KONKLuzionET NGA ANALIZA.....	4
Pjesa 1: Trajnimi fillestar	4
1.1. Çfarë kanë sjellë reformat? - Analiza e kornizës ligjore	4
1.2. Aplikimi i risive.....	5
1.3. Konkluzione.....	7
Pjesa 2: Zgjedhja e një gjykatësi në gjykatat e shkallës themelore dhe Gjykata administrative.....	8
2.1 Çfarë kanë sjellë reformat? - Analiza e kornizës ligjore.....	8
2.2. Aplikimi i risive.....	13
2.3 Përfundime.....	14
Pjesa 3. Monitorimi dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve.....	16
3.1 Çfarë kanë sjellë reformat? - Analiza e kornizës ligjore.....	16
3.2 Aplikimi i risive	20
3.3 Konkluzione	21
Pjesa 4: Zgjedhja e gjykatësit në gjykatë më të lartë dhe kryetar të gjykatës	22
4.1 Çfarë sollën reformat? -Analiza e kornizës ligjore.....	22
4.2 Aplikimi i risive	25
4.3 Konkluzione	25
Pjesa 5: Përgjegjësia disiplinore	26
5.1 Çfarë sollën reformat? -Analizë e kornizës ligjore.....	26
5.2 Përshkrim i reformave të aplikuara.....	27
5.3 Procedura për përcaktimin e përgjegjësive gjatë periudhës nga viti 2017 deri në vitin 2019.....	30
5.4 Konkluzione.....	31
Pjesa 6: Ndërprerja dhe shkarkimi nga funksioni gjyqësor.....	31
6.1 Çfarë sollën reformat? -Analizë e kornizës ligjore.....	31
6.2 Aplikimi i risive	37
6.3 Konkluzione.....	37
KONKLuzIONE DHE REKOMANDIME	39
ANEKSI I.....	43
LITERATURA E PËRDORUR.....	44

SHËNIME HYRËSE

Qëllimi dhe lënda e analizës

Gjykatësit si bartës të pushtetit gjyqësor janë mbrojtësit e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ata janë garantuesit më të lartë të mbrojtjes së sundimit të së drejtës. Ata janë zbatuesit e legjislacionit, shpërndarësit e drejtësisë dhe kreator të praktikës gjyqësore dhe si të tillë janë të detyruar ta rruajnë vendosmërinë e shtetit dhe gjyqësorit për të mbrojtur demokracinë e bazuar në sundimin e ligjit dhe promovimin e sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në ushtrimin e funksionit gjyqësor është e nevojshme të sigurohen kushte të tilla të cilat do të garantojnë pavarësi thelbësore të gjykatave si dhe pushtetit gjyqësor, por dhe pavarësinë individuale, paanshmërinë, cilësinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e gjyqtarëve gjatë vendosjes së lëndëve konkrete.

Strategjia për Reformën e Sektorit Gjyqësor për periudhën 2017 - 2022 përcaktoi udhëzime që synojnë përmirësimin e sistemit të gjyqësorit përmes tejkalimit të mangësive ekzistuese të karakterit normativ dhe institucional dhe parashikon më shumë masa të cilat kanë për qëllim forcimin e pavarësisë, paanshmërisë, cilësisë dhe përgjegjësisë së ushtruesve të pushtetit gjyqësor. Masat përfshinin ndërhyrje në kornizën ligjore, rregulloret, si dhe përforcimin kadrovik dhe teknik të gjykatave dhe Këshillit Gjyqësor.

Në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2019 u miratuan ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykatat¹ dhe Ligjit për akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publik² si dhe ligj plotësisht të ri për Këshillin Gjyqësor.³ Në këto tranzicione fazore të dobësive të gjetura në gjyqësor, konform vërejtjeve dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe GREKO, mes të tjerash pati ndryshime të ndjeshme në kushtet dhe procedurën për zgjedhje të gjyqtarëve në gjykatën themelore dhe të lartë, kriteret cilësore dhe sasiore për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjyqit në rast të avancimit të tyre, si dhe baza dhe procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe shkarkimi i tyre.

Duke pasur para sysh aktvendimet ligjore të reja dhe të ndryshuara sollën risi të shumta, ndryshimi i të cilave filloi me hyrjen e tyre në fuqi, por duke pasur para sysh dinamikën e mjedisit politik dhe juridik në vend, u imponua nevoja për analizë të cilësisë të kësaj pjese të reformave, zbatimi i tyre praktik dhe efekti i tyre.

Duke vazhduar angazhimin e saj për mbikëqyrje dhe pjesëmarrje në zbatimin e reformave transparente, inkluzive dhe cilësore, organizatat qytetare që punojnë në sferën e gjyqësorit dhe janë pjesë e Grupit Blueprint për reformë në gjyqësor e bënë këtë analizë e cila e elaboroi rrjedhën reformatore të karrierës gjyqtare nga kushtet dhe procedurës për pranim të trajnimit fillestar në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, kushtet dhe procedura për zgjedhje të gjyqtarit në gjykatë më të lartë dhe kryetarë të gjykatave, bazat dhe procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore deri në përfundimin dhe pushimin nga funksioni i gjyqtarit.

¹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RMV nr. 83/2018, 198/2018, 96/2019.

² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, Gazeta Zyrtare e RMV nr. 163/2018.

³ Ligji për Këshillin Gjyqësor të RMV, Gazeta Zyrtare e RMV nr. 102/2019.

Grupi përbëhet nga Instituti i të Drejtave të Njeriut, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shoqata e Avokatëve të Rinj të Maqedonisë, Instituti për Politika Evropiane, Qendra për Kërkime Ligjore dhe Analizë dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur - Maqedoni.

Duke pasur para sysh se Grupi Bluprint është pjesë e Këshillit për monitorim të zbatimit të Strategjisë në gjyqësorin 2017 - 2022, që paraqet trup adekuat për Ministrinë e drejtësisë dhe ka përfaqësuesit e vetë në grupet e punës për lidhe nga sfera e gjyqësorit, kjo analizë paraqet dokument për paraqitjen e mendimeve analitike dhe të ekspertëve të Grupit të Bluprintit për reforma në gjyqësorin dhe përpjekjen për të ndikuar në cilësinë e reformave.

Qëllimi kryesor i hulumtimit i kësaj analize është të identifikojë dhe në çfarë mase zgjidhjet e reja ligjore kontribuojnë në forcimin e pavarësisë, paanshmërisë, cilësisë dhe përgjegjësisë së gjyqësorit, si dhe të identifikojë dhe analizojë më tutje problemet dhe sfidat që janë shfaqur, në zhvillim, i cili mund të përbëjë pengesë për sundimin e ligjit. Gjendjet e konstatuara në analizën janë bazë për intervenimin në sferat nga të cilat priten rezultate të dukshme, përmban një vështrim kritik të ndryshimeve të bëra dhe zbatimin e tyre praktik në sferën e funksionit të gjyqtarit dhe mbrojtja e lirive themelore të njeriut dhe të drejtat si dhe sistemi juridik në tërësi.

Kjo analizë është përgatitur si pjesë e vazhdimit të një aksioni të përbashkët për të monitoruar reformën në drejtësi të Grupit Bluprint me titull "Për drejtësi - Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për reforma në gjyqësor 2019 - 2020" e cila u realizua me mbështetjen e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur - Maqedoni .

Ky veprim i përbashkët buroi nga nevoja për të vazhduar përpjekjet për zbatimin e reformave transparente, në kohë dhe llogaridhënies të sektorit të drejtësisë. Qëllimi i përgjithshëm i veprimit është të rrisë pjesëmarrjen dhe ndikimin e OShC-ve në procesin e zbatimit të Strategjisë për reforma në gjyqësor (2017 - 2022) dhe forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, veçanërisht duke vlerësuar përputhshmërinë me kornizën kohore të përcaktuar në Planin e Veprimit, transparencën e procesit, transparencën dhe gjithë përfshirjen, vlerësimin e cilësisë së ligjeve dhe politikave të propozuara dhe shkallën në të cilën janë realizuar qëllimet për shkak të cilave janë miratuar dhe ndikuar në procesin e reformave në gjyqësorin përmes përpilimit dhe dorëzimit të rekomandimeve të bazuara në prova mbi ligjet dhe politikat e propozuara dhe promovimin e debatit publik.

Metodologjia e përdorur

Fushat të cilat janë çështje e kësaj analize janë ndryshimet dhe plotësimet ligjore të miratuara, si dhe zgjidhjet e reja ligjore në lidhje me kushtet dhe procedurën për pranimit të trajnimit fillestar në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publik, kushtet dhe procedurat për zgjedhje në gjykatë më të lartë dhe zgjedhja e kryetarit të gjykatës, bazat dhe procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore si dhe përfundimi dhe shkarkimi i funksionit të gjyqtarit që janë parashikuar në Strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit 2017 - 2022 dhe Plani i Veprimit. Afati kohor i të dhënave të analizuara është nga fillimi i reformave, përkatësisht nga viti 2017 përfshirë tetorin e vitit 2019.

Metodologjia e përdorur për të mbledhur të dhënat për përpunimin e analizës përfshin shqyrtim të dokumentacionit dhe të dhënave statistikore. Dokumentet strategjike mbi të cilët bazohet analiza janë Strategjia për reformë në sektorin e gjyqësorit 2017 - 2022 me Plan Veprim dhe Plani 18. Përfshihet shqyrtimi i ndryshimeve, shtesave dhe zgjidhjeve të reja

ligjore për Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV, Ligjin për Akademinë për gjyqtarëve dhe prokurorët publikë. Analiza përfshin punën e Këshillit gjyqësor të RMV dhe Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë. Burimi i informacionit janë përmbajtjet e disponueshme të publikuara në ueb faqet të institucioneve të përfshira në analizë, Regjistri i vetëm elektronik i rregulloreve, si dhe të dhëna të mbledhura me anë të monitorimit të drejtpërdrejtë të Këshillit gjyqësor. Për përpunim të të dhënave të mbledhura janë zbatuar analiza normative, sasiore dhe cilësore në lidhje me aktvendimet ligjore paraprake dhe të reja.

Struktura e analizës

Analiza fillon me vërejtje hyrëse që përmbledhin qëllimin dhe lëndën e analizës si dhe metodologjinë e përdorur për mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Pas vërejtjeve hyrëse, analiza vijon me përmbajtjen dhe gjetjet e analizës. **Pjesa e parë** i kushtohet trajnimit fillestar të gjyqtarëve, gjegjësisht përpilimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit e Akademisë për gjyqtarët dhe prokurorët publik, i cili rregullon këtë çështje. Në **pjesën e dytë** analizohen ndryshimet e miratuara në lidhje me kriteret për zgjedhjen e gjyqtarit në Gjykatën Themelore dhe Administrative dhe në këtë drejtim janë përpunuar Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe Ligji për gjykatat. Në **pjesën e tretë** elaborohet mënyra e monitorimit dhe vlerësimit të punës së gjyqtarëve, e cila përfundimisht duhet të çojë në rritjen e cilësisë së vendimeve dhe mundësimin e zhvillimit të shkathtësive dhe aftësive të gjyqtarëve, gjë që do të rezultojë më tej në rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor. **Pjesa e katërt** merret me zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë, pra në gjykatat e apelit, në Gjykatën supreme dhe me zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave. **Pjesa e pestë** është e angazhuar për themelet e rafinuara për përgjegjësinë disiplinore. **Pjesa e gjashtë, e fundit** nga gjetjet e analizës shpjegojnë përfundimin dhe shkarkimin e gjyqtarit. Në çdo pjesë korniza ligjore ekzistuese është analizuar veçmas, gjegjësisht ndryshimet e miratuara dhe zbatimi praktik i risive dhe efekti i tyre, dhe janë prezantuar përfundime konkrete.

Dokumenti përfundon me konkluzë përmbledhëse dhe rekomandime të cilat dalin nga analiza e bërë.

KONKLuzionet nga Analiza

Pjesa 1: Trajnimi fillestar

1.1. Çfarë kanë sjellë reformat? - Analiza e kornizës ligjore

Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë (Gazeta Zyrtare e RM 163/2018)

Më 29.8.2018, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë.⁴ Qëllimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit ishte të adresohen mospërputhje të caktuara në lidhje me organet menaxhuese dhe drejtuese, si dhe janë bërë modifikime të mëtejshme në kriteret e pranimit të studentëve në Akademi.

Në lidhje me organet menaxhuese dhe drejtuese, detyrimet për të marrë testin psikologjik dhe testin e integritetit, të cilat deri më tani janë kaluar nga drejtori, anëtarët e Bordit Drejtues AGJPP dhe anëtarët e Këshillit Programues, janë ndërprerë. Për më tepër, ndryshimet ndërprejnë kërkesën e njohjes së gjuhës angleze të anëtarëve të Bordit Drejtues, Këshillit të Programit dhe ligjëruesit, dhe gjithashtu hoqën provimin për Drejtori, të cilin më parë kishin obligim ta kalojnë drejtori i Akademisë, anëtarët e Bordit drejtues dhe anëtarët e Këshillit të Programit.

Sa i përket kandidatëve për pranim, risia kryesore e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për AGJPP⁵ është heqja e mesatares së kërkuar të kandidatëve prej të paktën 8.0, e cila kufizoi shumë kandidatë të mundshëm për pranim. Për më tepër, në këtë drejtim është ndërprerë kriteri për studime pasuniversitare të detyrueshme të kandidatëve të cilët kanë arsim të lartë katër vjeçar, gradë VII / I në studime juridike.⁶ Sa i përket njohjes së tri gjuhëve më shpesh të përdorura, në vend të paraqitjes së një certifikate të njohjes së gjuhës, tani kandidatët për pranim kalojnë test për njohje të gjuhës angleze, franceze dhe gjermane.

Projektligji i ri për Akademinë për gjykatësit dhe prokurorët publikë

Në 12 maj 2019, ENER publikoi Projektligjin për Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë. Qëllimi i miratimit të Projektligjit të ri është heqja e kriterëve formale që pengojnë funksionimin efektiv të Akademisë së gjykatësve dhe prokurorëve publikë dhe opinionit të TAIEKS, mbi bazën e të cilit është e nevojshme të futet bazë ligjore për edukimin e gjyqtarëve porotë. Në korrik 2019 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u miratua Projektligji për Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë pas konsultimit publik përmes ENER dhe punës së grupit gjithëpërfshirës të punës së Ministrisë së Drejtësisë, i cili, ndër të tjera, ishte i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile.

Risitë e prezantuara nga Propozim-ligji janë rritja e mandatit të anëtarëve të Bordit drejtues së Akademisë nga dy vitet ekzistuese në katër vite. Sa i përket kompensimeve,

⁴ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë "Seanca nr. 58 e Kuvendit të RM e caktuar më 29.08.2018" (29 gusht 2018) <https://www.sobranie.mk/sessiondetails.nspx?sessionDetailsId=5f30c475-2ee9-4cac-9859-e9ec6841570f&date=29.8.2018> accessed 16 October 2019

⁵ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 163/2018, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Gjykatëse dhe Prokurorëve Publik

⁶ Blueprint grupi për reforma në drejtësi, "Analizë e zbatimit të strategjisë për reforma në drejtësi (2017 – 2022) për periudhën 2018/2019" <<https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/Blueprint-analiza.pdf>> accessed 16 October 2019.

anëtarët e Këshillit të programit do të kishin të drejtë *kompensim mujor* që në ligjin aktual është kompensim për *punën e mbaruar*. Shuma e kompensimit mujore është e parashikuar në aktet e Akademisë.⁷ Për më tepër, sipas Projektligjit, anëtarët e Bordit drejtues, Këshillit të programit dhe komisionet e provimeve pranues, për revidimin e provimeve dhe për provimin përfundimtar të Akademisë të emëruara në dy mandate para hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas rregulloreve që vlenin para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, nuk kanë të drejtë për edhe një mandat tjetër.⁸ Një zgjidhje e tillë bazohet në raportin TAIEKS, i cili rekomandon që Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Akademisë të kenë të drejtë vetëm për një rizgjedhje.

Shumica e ndryshimeve në Projektligj kanë të bëjnë me provimet pranuese dhe provimin përfundimtar në Akademi, si dhe kalimin e secilit prej moduleve në fazën e parë të trajnimit fillestar. Për të përmbushur rekomandimet e TAIEKS,⁹ afatet për paraqitjen dhe vendosjen e ankesave për rezultatet e provimit pranues janë zvogëluar. Kriteret për pranimin e kandidatëve në Akademi ruhen si në zgjidhjen aktuale ligjore, d.m.th mbeten të njëjtat dispozita në lidhje me ndërprerjen e mesatares së nevojshme, përcaktimin e njohjes të njërës prej gjuhëve duke dhënë testin në Akademi dhe ndërprerjes së kriterit për studime të domosdoshme post diplomike të kandidatëve të cilët kanë arsim të lartë katër vjeçar, shkalla VII/I në studime juridike.

Në lidhje me dhënien e provimit nga studentët e Akademisë, risitë kanë të bëjnë me faktin që lëndët që studiohen gjatë arsimit teorik janë të ndara në tre module të cilat zbatohen dhe jepen njëpasnjëshëm.¹⁰ Provimi përfundimtar përbëhet nga tre pjesë: 1. Pjesa me shkrim, 2. Simulimi i gjykimit dhe 3. Pjesa gojore. Simulimi i gjykimit si pjesë e provimit përfundimtar është një risi e rëndësishme¹¹ e cila prezantohet nga projekt-ligji sepse lejon kandidatët të përdorin njohuritë e tyre në praktikë.

Projekt-ligji gjithashtu parashikon risitë në përfaqësimin e drejtë të studentëve. Megjithatë përfaqësimi i përgjithshëm i drejtë është i ruajtur si në zgjidhjen e deritanishme ligjore, prapëseprapë në pjesën e raportimit nga ana e Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik për numrin e vendeve të lira për gjyqtarë dhe prokurorë publik në gjykatat themelore dhe prokuroritë publike themelore, tani këto institucione kanë obligim të raportojnë për përkatësinë e komuniteteve.

Një risi shtesë në Projektligjin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë u referohet personave që kanë marrë statusin e praktikantëve në trajnimin fillestar. Nëse ata ishin të punësuar në orar pune të papërcaktuar si gjyqtarë apo prokurorë publik, punësimi i tyre pushohet deri në përfundim të Akademisë dhe pasi të kalojnë provimin përfundimtar, ata kthehen në punë, gjegjësisht aty ku marrëdhënia e punës u kishte pushuar deri në emërimin e tyre si gjyqtar ose prokuror publik.¹²

1.2. Aplikimi i risive

Më 22 tetor 2018 u mbajt seanca konstituive e Bordit Drejtues të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Në seancë, u vunë në dukje emërimet e anëtarëve të Bordit Drejtues të AGJPP. Rrjedhimisht, u mor vendim për të zgjedhur Saso Rajçev, Prokuror Publik i

⁷ Neni 22 i Projektligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, të paraqitur në korrik 2019 në Kuvendin e RMV.

⁸ Bluprint grupi për reforma në drejtësi (neni 3).

⁹ ibid.

¹⁰ Neni 52 i Projektligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, të paraqitur në korrik 2019 në Kuvendin e RMV.

¹¹ Neni 56 i Projektligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, të paraqitur në korrik 2019 në Kuvendin e RMV.

¹² Neni 50 i Projektligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, të paraqitur në korrik 2019 në Kuvendin e RMV.

Prokurorisë Publike themelore të Shkupit si Kryetar i Bordit Drejtues të Akademisë, dhe Ola Ristova, Gjyqtare e Gjykatës Themelore Shkup 1, të zgjidhet Nënkyetar i Bordit Drejtues së Akademisë. Për më tepër, Bordi i Drejtorëve vendosi të ndërpresë mandatin e drejtorit aktual të Akademisë dhe të nxjerrë një shpallje publike për Drejtor dhe Zëvendës Drejtor, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Akademinë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë.¹³ Për më tepër, Bordi i Drejtorëve në të njëjtën ditë mori një vendim për shpalljen e njoftimit publik për zgjedhjen e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.¹⁴

Natasha Gaber-Damjanovska u emërua si Drejtore e AGJPP në mbledhjen e 138 të Bordit të Drejtorëve të AGJPP, të mbajtur në 28 nëntor 2018. Në konkursin publik për drejtor aplikuan 4 kandidatë. Megjithëse më parë shpallja publike parashikonte edhe pozicionin e Zëvendësdrejtorit, Bordi Drejtues vendosi që kandidati i vetëm për këtë pozicion nuk plotësonte një nga kushtet e listuara në konkurs, d.m.th. kandidati nuk ka paraqitur një dokument të dosjes penale. Sa i përket kohës së shkrimit të këtij dokumenti, nuk është shpallur asnjë konkurs d për zëvendës drejtor, për pasojë, Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë nuk ka zëvendës drejtor.

Në një takim të mbajtur më 18 qershor 2019, Bordi i Drejtorëve i AGJPP mori vendim për caktimin e një provimi përfundimtar për studentët e gjeneratës VI. Provimi përfundimtar u mbajt në 5 korrik 2019, në orën 10 të mëngjesit në ambientet e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Gjithsej 37 kandidatë të Gjeneratës VI kaluan me sukses testet dhe diplomat e tyre u dhanë në 9 tetor 2019.¹⁵

Këshilli Drejtues i Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë "Pavel Shatev", në seancën e mbajtur më 3.6.2019, miratoi Programin për Provimin pranues në Akademinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë "Pavel Shatev" për vitin 2019 dhe miratoi aktet e mëposhtme: Vendim statutor për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë "Pavel Shatev"; dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kalimin e provimit të pranimit në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publik "Pavel Shatev".

Bordi Drejtues i Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, në seancën e tij të mbajtur më 9.5.2019, mori vendim për shpalljen e një thirrje publike për pranimin e studentëve të gjeneratës së re VII të trajnimit fillestar në Akademinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë "Pavel Shatev".¹⁶ Sipas raporteve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë për vendet e lira të punës në gjykata dhe prokurori, numri i kandidatëve që duhej të reklamohesh në AGJPP ishte 120, nga të cilët 65 ishin të projektuar për ndjekjen penale, dhe 55 për gjykatat.¹⁷ Sidoqoftë, për shkak të kapaciteteve me hapësirë, Akademia shpalli listë me 60 kandidatë, nga të cilët tridhjetë kandidatë që kryejnë me sukses trajnimin do të duhet të ndahen në gjykata, dhe tridhjetë kandidatë në prokuroritë publike. Shpallja publike u publikua

¹³ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 163/2018)

¹⁴ Iva Conevska dhe të tjerë "Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën qershor 2018 – mars 2019 (2019)

¹⁵ Makpress.mk, "Diploma janë ndarë për 37 kandidate për gjykatës dhe prokurorë publik (10 September 2019) <<https://makpress.mk/Home/PostDetails?PostId=308972>> accessed 18 October 2019.

¹⁶ akademik.mk, 'Konkurs publik për pranim në trajnim fillestar në Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik "Pavel Shatev" (17 May 2019) <<https://akademik.mk/javen-oglas-za-priem-vo-pochetna-obuka-vo-akademijata-za-sudii-i-javni-obviniteli-pavel-shatev/>> accessed 18 October 2019.

¹⁷ nezavisen.mk, 'Intervistë me Natasha Gaber - Damjanovska: Shteti paguan për trajnimin e gjykatësve të ardhshëm dhe prokurorëve' (2 June 2019) <<https://nezavisen.mk/intervju-so-natasha-gaber-damjanovska-drzhavata-plakja-za-obukata-na-idnite-sudii-i-obviniteli/>> accessed 18 October 2019.

në 15 maj 2019 në Gazetën Zyrtare, gazetat ditore "Nova Makedonija" dhe "Lajm", dhe në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publik. Për shpalljen publike kanë aplikuar rreth 670 kandidatë, që është një numër dukshëm më i lartë i kandidatëve të regjistruar për gjeneratën VI të konkursit të shpallur në vitin 2016.¹⁸ Kjo kryesisht për shkak të lehtësimit të kriterëve për pranimin e kandidatëve në lidhje me heqjen e mesatares së kandidatëve dhe heqjen e kriterit për studime pasuniversitare të detyrueshme të kandidatëve që kanë katër vjet arsim të lartë, pra shkallën VII / I në studimet e juridikut.

Bazuar në kandidatët e paraqitur për gjeneratën VII të studentëve me trajnim fillestar, AGjPP më 26-27 gusht zbatoi testin për një nga tre gjuhët më të përdorura në BE (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) në Qendrën Kompjuterike të Fakultetit të Drejtësisë në Shkup. Testet e Kualifikimit AGjPP ishin planifikuar për periudhën 10-14 Shtator 2019 në qendrën e provimeve të Fakultetit Juridik. Të drejtë të kalojnë provimin kishin kandidatët që kaluan testin e njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të BE-së. Testi psikologjik për kandidatët që kaluan provimin kualifikues ishte caktuar për 12 dhe 13 tetor në Fakultetin Filozofik në "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup. Metodologjia për vlerësimin e testeve psikologjike, si dhe dinamika e kontrollimit të testeve psikologjike, nuk janë në kompetencën e AGjPP-së pasi ato shqyrtohen nga ekspertë të një institucioni të pavarur dhe plotësisht të akredituar.

Në ndërkohë, AGjPP punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e trajnimit, duke prezantuar temat e nevojshme të trajnimit, bazuar në vlerësimet e trajnimeve të kryera dhe projekt-temat e paraqitura nga Këshilli gjyqësor, Këshilli i prokurorëve publikë, ekspertët dhe OJQ-të.¹⁹ Në periudhën e kaluar u mbajtën disa konsultime dhe trajnime për tema të ndryshme. Disa nga temat e përfshira kanë të bëjnë me teknikat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, ndërmjetësimin dhe arbitrimin, përmirësimin e sistemit në fushën e dhunës në familje, praktikën gjyqësore në lidhje me sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të mediave, dhe tema të tjera që janë të rëndësishme për përmirësimin e punës së gjykatave dhe prokurorive me qëllim forcimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të këtyre institucioneve.

1.3. Konkluzione

Edhe pse u kërkuar gjithsej 120 gjyqtarë dhe prokurorë të rinj nga Këshilli gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publikë, Akademia për gjykatësit dhe prokurorët siguruan kapacitete për vetëm 60 studentë për shkak të mungesës së hapësirës.²⁰ Prandaj, ekziston nevoja për të rritur kapacitetin e Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë në lidhje me ambientet me një fokus të veçantë në objektet e trajnimit, por ekziston edhe nevoja për të rritur buxhetin dhe stafin në mënyrë që të sigurohet trajnim më i mirë për studentët, gjyqtarët, prokurorët publik dhe personeli mbështetës si dhe zbatimi i rekomandimeve TAIEKS të bëra në këtë drejtim. Për sa i përket stafit, gjithsej 36 vende pune janë plotësuar, ndërsa 64 vende pune janë të sistematizuara.²¹ Deficiti më i madh për postet e plotësuar është në sektorët për

¹⁸ 24info.mk, 'Gaber: Akademia punon në mënyrë profesionale dhe nuk favorizon kandidatët të caktuar' (9 October 2019) <https://24info.mk/%d0%b3%d0%b0%d0%b1%d0%b5%d1%80-%d0%b0%d0%ba%d0%b0%d0%b4%d0%b5%d0%bc%d0%b8%d1%98%d0%b0%d1%82%d0%b0-%d1%80%d0%b0%d0%b1%d0%be%d1%82%d0%b8-%d0%bf%d1%80%d0%be%d1%84%d0%b5%d1%81%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0/> accessed 18 October 2019.

¹⁹ Projekt i Grupit të Reformës Gjyqësore, 'Analizë e Zbatimit të Strategjisë së Reformës në Sektorin Gjyqësor (2017-2022) për periudhën 2018/2019' <<https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/Blueprint-Analysis.pdf>> e qasshme më 16 Tetor 2019

²⁰ nezavisen.mk, 'Intervistë me Natasha Gaber - Damjanovska: Shteti paguan për trajnimet e gjykatësve dhe prokurorëve të ardhshëm' (2 June 2019) <<https://nezavisen.mk/intervju-so-natasha-gaber-damjanovska-drzhavata-plakja-za-obukata-na-idnite-sudii-i-obviniteli/>> accessed 18 October 2019.

²¹ Analiza funksionale për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik, Shkup, Nëntor 2019

trajnim dhe çështje financiare. Përkatësisht, në sektorin e trajnimeve 13 janë sistematizuar dhe vetëm 4 vende janë plotësuar, ndërsa në sektorin e çështjeve financiare 7 janë sistematizuar dhe vetëm një vend është i plotësuar.

Për më tepër, AGjPP duhet t'i mundësohen burime buxhetore që të krijohen kushte për përdorimin e ambienteve të tilla si sallë leximi, bibliotekë dhe salla gjyqi ku studentët mund të ushtrojnë funksione gjyqësore dhe prokurore publike. Gjithashtu është e nevojshme të rritet personeli i kërkuar për zbatimin e kompetencave ligjore të AGjPP të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorët publikë. AGjPP ka gjithsej 18 punonjës, dhe ka vende pune që nuk janë të plotësuara. Qeveria duhet të angazhohet në periudhën tjetër. Për të përmbushur nevojat e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, Qeveria do të duhet të ndajë më shumë fonde buxhetore në periudhën tjetër kur përpilon buxhetin e shtetit për të ndarë më shumë mjete për punën e AGjPP.

Në kohën e shkrimit të kësaj analize, në ueb faqen e Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë (www.jpacademy.gov.mk) është ri-dizajnuar plotësisht me një pamje moderne. Edhe pse relativisht e re, arkivi nga ueb faqja e mëparshme nuk është i integruar. Në këtë drejtim, postimet e vjetra në faqen e internetit duhet të integrohen për transparencë dhe dukshmëri më të madhe të historisë së punës së Akademisë.

Pjesa 2: Zgjedhja e një gjykatësi në gjykatat e shkallës themelore dhe Gjykata administrative

2.1 Çfarë kanë sjellë reformat? - Analiza e kornizës ligjore

Zgjedhja e gjyqtarit në gjykatat themelore dhe në Gjykatën Administrative është çështje e rregulluar nga Ligji për Gjykatat²² dhe me Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor të RMV,²³ ku është përshkruar që Këshilli Gjyqësor i RMV, si një organ i pavarur i gjyqësorit, është përgjegjës për procesin e zgjedhjes, vlerësimit, promovimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve.

Sipas Strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor, reforma në drejtësi është e ndarë në tri faza, pra tre grupe të ndryshimeve në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV dhe Ligjin për gjykatat.

Në 2017 dhe 2018 janë bërë dy ndryshime në Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe ato janë miratuar nga Kuvendi.²⁴ Në përputhje me udhëzimet në Strategjinë e reformës në sektorin gjyqësor, rekomandimet e Komisionit të Venecias, GREKO dhe rekomandimet e Misionit të Vlerësimit TAIEKS nga Prilli 2018, u miratua ndryshimi i tretë, përkatësisht Ligji i ri për Këshillin gjyqësor i cili u miratua dhe u botua në Gazetën Zyrtare të RMV ", nr. 102 prej 22.5.2019. Ligji i ri për Këshillin gjyqësor është një nga ato që presidenti i mëparshëm nuk e ka nënshkruar për shkak të ndryshimit të emrit të shtetit, pas së cilës deputetët votuan në seancën e parë pas zgjedhjeve presidenciale.

²² Ligji për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe " Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut"nr. 96/2019)

²³ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë Veriore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

²⁴ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)

Ligji për Gjykatat gjithashtu është ndryshuar tri herë, dy herë në 2018 dhe i treti, herën e fundit në 2019.²⁵

Megjithëse Strategjia e Reformës në Sektorin Gjyqësor parashikon miratimin e një Ligji të ri për Gjykatat, megjithatë në periudhën nga miratimi i Strategjisë pasuan tre ndryshime në këtë Ligj.²⁶ Këto ndryshime ofrojnë një kornizë të qëndrueshme ligjore dhe kanë për qëllim ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe u mirëpritën në raportin e fundit të Komisionit Evropian për vendin tonë.²⁷

Si Ligji për Gjykatat ashtu edhe Ligji për Këshillin gjyqësor të RMV-së përcaktojnë procedurën për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë Veriore, e cila fillon me miratimin e vendimit për vende të lira për gjyqtarë në gjykatat themelore nga Këshilli gjyqësor i RMV-së. Ky vendim merret nga Këshilli gjyqësor i RMV pas një mendimi të marrë nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mendimi i seancës së gjyqtarëve të gjykatës përkatëse, bazuar në analizën dhe projektimin e pozitave të lira gjyqësore dhe zbatimin e parimit të përfaqësimit të drejtë të anëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.²⁸

Këshilli Gjyqësor merr vendim për konkursin e gjykatave të shkallës së parë pranë Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë jo më vonë se 31 Mars të vitit në të cilin është marrë vendimi.²⁹ Shtrohet pyetja në lidhje me rëndësinë e këtij vendimi në praktikë duke marrë parasysh faktin se megjithëse Këshilli gjyqësor më 14.3.2019 vendosi që numri i vendeve të lira të punës për gjykatat themelore ishte 55 për gjeneratën VII të kandidatëve për gjyqtarë në AGJPP, por për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të hapësirës, AGJPP bëri shpallje publike për 30 kandidatë për gjyqtarë.

Gjithashtu, pas zbrazjes së një posti gjyqësor ose nevojës për një post gjyqësor, dhe me kërkesë të gjykatës, Këshilli gjyqësor merr vendim për shpallje publike për zgjedhje të gjyqtarit. Shpallja publikohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në të paktën dy gazeta njëra prej të cilave është në një gjuhë tjetër përveç Maqedonishtes e folur nga të paktën 20% e qytetarëve të RMV-së dhe zgjat 15 ditë nga data e botimit në Gazetën Zyrtare.³⁰

Kërkesat e përgjithshme që një person duhet të përmbushë për të qenë gjyqtar janë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të zotërojë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në gjendje të punojë dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore që dëshmohet me një certifikatë mjekësore,
- të ketë kryer studime juridike me 300 ECTS ose shkalla VII / 1 në drejtësi ose diplomë të nostrifikuar nga studimet juridike vendit për 300 kreditë të fituara,
- të ketë kaluar provimin e jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë,

²⁵ Ligji për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

²⁶ Blueprint grupi për reforma në drejtësi "Analizë për ballafaqim me strategjinë për reforma në sektorin e drejtësisë E qasshme në: <http://ihr.org.mk/uploads>

²⁷ ibid

²⁸ Neni 44 paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

²⁹ Neni 45 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019)

³⁰ Neni 46

- Njohuri për njërin nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht),
- në kohën e zgjedhjes me aktvendim gjyqësor i plotfuqishëm nuk i është shqiptuar asnjë dënim ose sanksion kundërvajtës duke ndaluar ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës për një vepër penale të lidhur me ndjekjen e profesionit juridik ose për ndonjë vepër tjetër penale të dënueshme me burgim të paktën gjashtë muaj,
- të zotojë punën praktike me kompjuterë,
- të gëzojë reputacionin, të ketë integritet në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, dhe
- zotërojnë aftësi sociale për të kryer funksionin gjyqësor, për të cilin kryhen teste të integritetit dhe teste psikologjike.³¹

Me risitë, përcaktimi i shëndetit të përgjithshëm nuk do të bëhet me ekzaminime shëndetësore siç ishte rasti, por kandidati duhet ta vërtetojë atë me vërtetim mjekësor. Për më tepër, kandidatët për gjyqtarë nuk kërkohet të jenë të aftë në një gjuhë të veçantë të huaj, d.m.th. kalimi testit të gjuhës është brenda provimit pranues të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, ku vetë testi përcakton nivelin e njohurive të gjyqtarit të ardhshëm, dhe nëse pranohet në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë do të mundësohet avancim i mëtejshëm i njohurive të gjuhëve të huaja.

Zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën themelore

Kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatën themelore parashikojnë që gjyqtari i gjykatës themelore të zgjidhet vetëm:

- person i cili ka përfunduar trajnimet në Akademinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë të përcaktuar me ligj, dhe
- person i cili ka të paktën katër vjet përvojë të stazhit të pandërprerë gjyqësor si gjyqtar në gjykatë tjetër themelore deri në datën e aplikimit për zgjedhje, i cili është vlerësuar nga Këshilli Gjyqësor me vlerësim pozitiv, në përputhje me Ligjin për Këshillin gjyqësor.³²

Zgjedhja e gjyqtarit në Gjykatën Administrative

Sa i përket zgjedhjes së gjyqtarit në Gjykatën Administrative, vërehet forcimi i kriterëve për zgjedhje të gjyqtarit për shkak të vendimit të kaluar ligjor që parashikonte se i gjyqtarë të Gjykatës administrative mund të zgjidhen edhe persona të cilët kanë të paktën 5 vjet stazh shërbime juridike në një organ shtetëror, me rezultate të vërtetuara për punë, ndërsa me ndryshimet më të reja ligjore përshkruhet se gjyqtarit i Gjykatës administrative mund të zgjidhet vetëm gjyqtar i cili ka përvojë pune prej së paku katër vite stazh pune si gjyqtar i gjykatës themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, dhe i cili, nga Këshilli gjyqësor është vlerësuar me notë pozitive.³³

Lajm i rëndësishëm është se përfundimi i trajnimeve të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë është duke u bërë mënyra e vetme për të filluar karrierë gjyqësore.

Kështu, Këshilli Gjyqësor zgjidhjen e gjyqtari të gjykatës themelore e kryen nga renditja e kandidatëve e paraqitur nga Akademia për gjyqtarëve dhe prokurorë publik që janë

³¹ Neni 45 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

³² Neni 46 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

³³ Neni 45 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019)

paraqitur në shpalljen dhe me radhë sipas suksesit të arritur të përcaktuar në listën e renditjes, si dhe rezultatet e intervistës së zhvilluar nga Këshilli gjyqësor.³⁴

Zbatimi i intervistës së kandidatëve për gjykatën e themelore, e cila vlerësohet nga Këshilli gjyqësor dhe shënohet me maksimum prej 10% të totalit të pikëve,³⁵ është risi e parashikuar në ligjin e ri dhe presupozon vlerësimin e kompetencave personale dhe sociale të kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat themelore. Nga këtu del mundësia të shmanget pranimi i detyrueshëm i listës së paraqitur nga AGjPP dhe me këtë risi u pranuan kritikrat për atë se mënyra paraprake e zgjedhjes së gjyqtarit nuk le mundësinë Këshilli gjyqësor të zbatojë kriteret e tjera gjatë zgjedhjes, por puna e tij i referohet kryerjes formale të zgjedhjes që ngjason në emërimin e kandidatit për gjyqtar, dhe ana pozitive është se u precizua legjislacioni në lidhje me zgjidhjen e gjyqtarëve. Pas kryerjes dhe vlerësimit të intervistës, Këshilli Gjyqësor i RMV ka mundësinë të ndryshojë renditjen e kandidatëve në renditjen përfundimtare dhe megjithëse elementi subjektiv i intervistës nuk mund të lihet pas dore, kjo risi vlerësohet si pozitive.

Ligji për Këshillin gjyqësor të RMV përcakton që Këshilli të diskutojë dhe të vendosë për zgjedhjen e gjyqtarit, në seancë ku marrin pjesë të paktën tetë vota të anëtarëve të Këshillit gjyqësor me të drejtë vote.³⁶ Këshilli Gjyqësor përbëhet nga 15 anëtarë, nga të cilët anëtarë në funksion janë Kryetari i gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministri i Drejtësisë, dhe ata marrin pjesë në punën e Këshillit pa të drejtë vote.³⁷ Në vendimet e kaluara legjislative nga viti 2018 presidenti i Gjykatës supreme, si anëtar i Këshillit gjyqësor, kishte të drejtë të votonte, por nuk mund të ishte anëtar i Këshillit i cili vendos me të drejtë ankese ndaj vendimeve të marra nga Këshilli gjyqësor i RMV-së.

Kjo risi në lidhje me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Gjykatës supreme në seanca pa të drejtë vote duhet të kontribuojë në ndarje thelbësore të gjyqësorit dhe ekzekutivit në marrjen e vendimeve të rëndësishme për gjyqësorin dhe të pengojë më tej në dy raste vendimmarrjen e kryetarit të Gjykatës supreme që ka të drejtën e ankimit të një kandidati të pazgjidhur në Këshillin e Apelit të Gjykatës supreme, të cilën do ta shtjellojmë në vijim.

Shqyrtimi dhe marrja e vendimeve kryhen në përputhje me renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote është i detyruar në Seancën e Këshillit të arsyetojë me gojë vendimin e tij / saj për zgjedhjen e gjyqtarit.³⁸ Shpjegimi i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për vendimin e kandidatit është risi që kontribuon në cilësi më të madhe në përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe transparencë më të madhe të punës së Këshillit gjyqësor të RMV-së.

Konsiderohet i zgjedhur kandidati që merr të paktën tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote dhe kandidati njoftohet me shkrim, vendimi për zgjedhje publikohet në ueb faqen e Këshillit dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.³⁹ Në monitorimin e Këshillit Gjyqësor nga Instituti i të Drejtave të Njeriut, është vërejtur në praktikë deri më tani që votimi për gjyqtar përfundon

³⁴ Neni 47 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019)

³⁵ ibid

³⁶ Neni 45 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019). Ekziston një gabim gjuhësor në këtë këndvështrim, por nuk është e vështirë të interpretohet, megjithëse Këshilli diskuton dhe vendos në seancë ku marrin pjesë të paktën tetë anëtarë të Këshillit Gjyqësor me të drejtë vote.

³⁷ Neni 6 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019)

³⁸ Neni 49

³⁹ Neni 49 paragrafi 1 ibid

kur i pari i kandidatëve që renditen në mënyrë rreshtore në renditje votohet me numër të mjaftueshëm votash (në zgjidhjen e kaluar ligjore ato ishin dy të tretat e votave të Këshillit Gjyqësor) pa dhënë mundësinë për të votuar për kandidatët e ardhshëm në listën e renditjes, të cilët ka të ngjarë të votohen me një numër më të madh votash se ai i mëparshmi. Shtrohet pyetja se cila do të jetë procedura e votimit nëse kandidatët në renditje kanë të njëjtin numër pikësh nga suksesi i AGjPP dhe intervistës.

Ligji i ri për Këshillin gjyqësor të RMV parashikon më tej se Këshilli mund të zgjedhë gjyqtar të një gjykate themelore i cili është paraqitur në shpallje për gjyqtar të një gjykate tjetër themelore nëse në shpalljen nuk është paraqitur kandidat nga Akademia e gjykatësve dhe prokurorët publikë.⁴⁰ Këtu lind pyetja nëse një dispozitë e tillë nuk është kufizuese për gjyqtarët e gjykatave themelore që janë paraqitur në konkurs të shpallur për gjyqtar në një gjykatë tjetër themelore dhe nëse zgjedhja e tyre nuk duhet të jetë e mundur vetëm nëse paraqitet një kandidat nga Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publik.

Një kandidat i cili nuk është zgjedhur gjyqtar ka të drejtë të ankohet brenda tetë ditëve nga marrja e njoftimit në Këshillin e Apelit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë Veriore.⁴¹ Mjetet juridike të një kandidati të pazgjidhur, domethënë mundësia për ankim në Këshillin e apelit të Gjykatës supreme, është risi që mundëson që Këshilli gjyqësor të jetë i përgjegjshëm dhe Gjykata supreme përfshihet më shumë në zgjedhjen e magjistratëve në vend.

Është i garantuar përfaqësimi i barabartë dhe adekuat në zgjedhjen e gjyqtarëve, kështu që kur të zgjidhni gjyqtar në gjykatë themelore të vendosur në një zonë të vetëqeverisjes lokale, ku 20% e qytetarëve flasin një gjuhë zyrtare, përveç asaj maqedonase, duhet të ketë shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm që u përkasin bashkësive jo-shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁴² Kur Këshilli Gjyqësor zgjedh një gjyqtar të Gjykatës Administrative, duhet të ketë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm që u përkasin bashkësive jo-shumicë në Republikën e Maqedonisë Veriore.⁴³

Në çdo rast, si gjyqtar nuk mund të zgjidhet person i cili me gjyqtarin në gjykatë është në lidhje fisnore të brezit të parë ose në linjë anësore deri në shkallën e tretë ose partner martesor i tij. Për më tepër, si gjyqtar nuk mund të zgjidhet person i cili me anëtar të Këshillit gjyqësor të RMV-së është në lidhje fisnore të brezit të parë ose nga linjë anësore deri në shkallë të tretë apo bashkëshort.⁴⁴

Nëse, pas një procedure për zgjedhjen e gjyqtarit ose kryetar të gjykatës, Këshilli gjyqësor përcakton se nuk ka kandidat të paraqitur ose të gjithë kandidatët janë vlerësuar me notë negative, do të sjellë vendim për rishpallje për zgjedhje të gjyqtarit.⁴⁵

Pas rekomandimeve të Misioni i Vlerësimit TAIEKS, është përfshirë një risinë Ligjin për gjykatat që një person i cili ka shërbyer të paktën një mandat si gjykatës i gjykatës ndërkombëtare dhe që përmbush kushtet, mund të zgjidhet për gjyqtar i të gjitha niveleve.⁴⁶

⁴⁰ Neni 47 paragrafi 6 ibid

⁴¹ Neni 49 paragrafi 5 ibid

⁴² Neni 50 paragrafi 1 ibid

⁴³ Neni 50 paragrafi 2 ibid

⁴⁴ Neni 43 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

⁴⁵ Neni 52 ibid

⁴⁶ Neni 46 paragrafi 3 ibid

Gjithashtu, një lajm domethënës në ndryshimet në Ligjin për gjykatat është mundësia e zgjatjes së mandatit të gjyqtarëve që deri më tani u është kërkuar ligjërisht të dalin në pension në 64 vjet, por tani kanë mundësinë të vazhdojnë punën deri në 67 vjet, në përputhje me Ligjin e marrëdhënieve të punës.⁴⁷

Ndryshimet për herë të parë parashikojnë që një gjyqtar i zgjedhur në territorin e një gjykate themelore ose të apelit mund, pas skadimit të një numri vjetësh të shërbimit gjyqësor të vazhdueshëm në gjykatën në fjalë, të jetë në gjendje të zgjidhet në territorin e një gjykate tjetër themelore ose të apelit.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat përmban nen të ri që prezanton një kategori të re të gjyqtarëve të ashtuquajtur të gjyqtarë të rinj, i cili parashikon që gjyqtari i sapo zgjedhur brenda dy viteve do të gjykojë çështje brenda juridiksionit të një gjykate themelore të kompetencave themelore. Është vlerësuar se periudha prej dy vitesh është e mjaftueshme për arritjen e mjaftueshme të profesionalizmit gjyqtar të gjyqtarëve të rinj që të mund të përfshihen në renditjen e rregullt të lëndëve rrjedhëse, në pajtim me rekomandimin e Misionit të Vlerësimit TAIKS.⁴⁸

Një gjyqtar i një gjykate themelore mund të dërgohet për më së shumti një vit për të gjykuar në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë ose më të ulët, ose nga një seksion në një seksion tjetër të specializuar, kur për shkak të pengesës dhe përjashtimit të një gjyqtari është rritur ndjeshëm vëllimi i punës, zvogëlimi i afatit kohor ose për shkak të natyrës së ndërlikuar të lëndëve vihet në pyetje veprimi aktual i gjykatës, por jo më shumë se një herë brenda pesë viteve. Me këtë zgjidhje pamundësohet që dërgimi dhe sistematizimi të përdoren si formë e presionit.⁴⁹ Me ndryshimet e fundit ligjore, gjyqtari mund të dërgohet në gjykatë tjetër vetëm një herë në 5 vjet. Në këtë drejtim, me propozimin e Komisionit të Venecias, futen garancitë në rast të dërgimit të gjyqtarëve në një gjykatë tjetër ose kur ata janë caktuar në gjykatë më të ulët për shkak të situatave të caktuara.⁵⁰

2.2. Aplikimi i risive

Pas kritikave të shumta nga publiku për punën e Këshillit gjyqësor, ndryshimet e para dhe të dyta në Ligjin për Këshillin Gjyqësor u konstatua që Këshilli Gjyqësor të tregojë shkallë më të lartë të efektivitetit në punën e tij, duke u përpjekur të zbatojë mundësitë e dhëna ligjore në zgjedhjen e gjyqtarëve. Në këtë drejtim, vendimet për zgjedhje në vitet 2017 dhe 2018 ndryshojnë nga ato të miratuara në 016 për shkak se përmbajnë listë të plotë të kandidatëve të paraqitur, numri i poenëve, të dhënat biografike për kandidatët, stazhi i përgjithshëm dhe rezultatet e anketës anonime. Në këto dy faza, ose ndryshimet, risia për mundësinë për arsyetim me gojë të vendimit për zgjedhje të gjyqtarit nga anëtarët e Këshillit gjyqësor me të drejtë vote kontribuoi në një transparencë më të madhe dhe llogaridhënie të Këshillit gjyqësor dhe cilësi më të madhe gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, por jo çdo herë është respektuar plotësisht në dy fazat e parë të reformave.

⁴⁷ Instituti i të Drejtave të Njeriut, Raporti Monitorues për punën e Këshillit Gjyqësor të RSM maj - gusht 2019, i qasshëm në [http://ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/IHR%20-%20Monitoring%204-2019%20\(web\).pdf](http://ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/IHR%20-%20Monitoring%204-2019%20(web).pdf)

⁴⁸ Neni 48 paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

⁴⁹ Blueprint grupi për reforma në drejtësi "Analizë për ballafaqim me strategjinë për reforma në sektorin e drejtësisë e qasshme në: <http://ihr.org.mk/uploads>

⁵⁰ Analiza e Zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor (2017-2022) për periudhën 2018/2019, Grupi i Reformës Gjyqësore

Nga implementimi i fazës së tretë të reformave, përkatësisht hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor të RMV-së dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat deri në momentin e shkrimit të analizës, Këshilli gjyqësor nuk ka zgjedhur gjyqtarët për gjykatat themelore sipas kriterëve dhe procedurave të reja.

Gjatë kësaj periudhe, në shtator 2019 u bë zgjedhje e një gjyqtari i Gjykatës Supreme nga sfera e kimit, dhe në tetor 2019, U zgjodhën tetë kryetarë të Gjykatave Themelore, përfshirë Gjykatën themelore Manastir me Gjykatën themelore Demir Hisar, Gjykatën themelore Veles, Gjykatën themelore Delçevë, Gjykatën Themelore Kërçovë me Njësinë në Makedonski Brod, Gjykatën Themelore Kriva Pallanka, Gjykatën themelore Prilep, Gjykatën themelore Civile Shkup dhe Gjykata themelore Shtip. Duke pasur parasysh që shpalljet për këto zgjedhje janë botuar përpara ndryshimeve të reja legjislative, zgjedhjet e lartpërmendura janë bërë sipas kriterëve dhe procedurës së përzgjedhjes së mëparshme.

Në periudhën raportuese, në tetor 2019, u zgjodhën dy gjyqtarë në Gjykatën Administrative për të cilën Këshilli gjyqësor shpalli një vend të lirë.⁵¹ në janar 2019 sipas kriterëve që ishin në fuqi para ndryshimeve më të fundit në Ligjin për Këshillin gjyqësor, kur për gjyqtarë në Gjykatën Administrative mund të konkurronin persona të cilët kanë kryer Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publik dhe të paktë pesë vjet stazh në shërbim juridik në organ shtetëror, me rezultate të vërtetuara në punë. Për të dy vendet në Gjykatën Administrative janë paraqitur 31 kandidatë.⁵²

Zbatimi i dispozitave të reja ligjore në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatat themelore dhe Gjykatën administrative, me kriteret e reja të zgjedhjes, mbetet të shihet në të ardhmen.

Që nga miratimi i Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor të RMV-së, janë bërë disa transferime të përkohshme si rezultat i mungesës së gjyqtarëve në disa gjykata në vend. Në të kaluarën, Këshilli për Gjyqësorin i transferonte gjyqtarët në gjykata të tjera, dhe të njëjtëve gjyqtarë shpesh u ishte zgjatur transferi. Me ndryshimet e fundit ligjore, gjyqtari mund të transferohet në gjykatë tjetër vetëm një herë në 5 vjet. Me transferimet, Këshilli Gjyqësor përsëri transferoi gjyqtarët e njëjtëve që ishin dërguar të gjykojnë në një gjykatë tjetër, megjithëse Ligji i ri ishte në fuqi. Një gjykatës apeloj kundër vendimit të kërkesës, i cili u refuzua nga Këshilli gjyqësor. Në shpjegimin e vendimit të marrë nga Këshilli Gjyqësor, anëtarët u uhdëhoqën nga nevoja e qytetarëve për realizimin e të drejtave të tyre, gjatë kësaj duke u kujdesur të mos vonohet puna e gjykatës, e cila do të çonte në një numër të shtuar të lëndëve të vjetra. Duhet të theksohet se vendimi nuk ishte unanim. Asnjë sqarim tjetër nuk u dha, pasi gjykata nga e cila po transferohet gjyqtari është gjykatë më e madhe dhe ka gjyqtarë të tjerë që mund të transferohen.

2.3 Përfundime

Miratimi i Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Gjykatat dhe Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor buron nga nevoja për reformë gjyqësore të përcaktuar në Strategjinë për Reformën e Sektorit Gjyqësor, me qëllim të përmirësimit të sistemit gjyqësor dhe funksionimi të tij. Me ndryshimet e fundit në Ligjin për gjykatat, u bë harmonizimi me ndryshimet e parashikuara në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

⁵¹ Lista nr.08-45 / 2 i datës 15.01.2019, Këshilli Gjyqësor i RMV

⁵² Këshilli Gjyqësor i RMV, Njoftim nga mbledhja e 320-të e mbajtur më 2.10.2019, në dispozicion në <http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti>

Ndryshime më të rëndësishme në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV dhe Ligji për gjyqtarë, në lidhje me përqindjen e zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe Gjykatës Administrative të cilat ndikojnë në cilësinë e gjyqësorit janë:

- Gjyqtarët e Gjykatës themelore do të zgjidhen vetëm nga lista e kandidatëve që kanë aplikuar për vendin e lirë, të paraqitur nga Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë në Këshillin gjyqësor të RMV, d.m.th. përfundimi i trajnimit të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë bëhet mënyra e vetme për të filluar një karrierë gjyqësore,

- Gjatë zgjedhjes së gjyqtarit, Këshilli gjyqësor do të marrë në konsideratë vitin e përfundimit të trajnimit dhe suksesin e arritur, si dhe rezultatet e intervistës,

- Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatat themelore, Këshilli gjyqësor, për herë të parë, do të zhvillojë intervistë me kandidatët, që vlerësohet me 10% të pikëve që merr kandidati, duke ndryshuar kështu funksionin e Këshillit gjyqësor në zgjedhjen e gjyqtarëve i referohet kryerjes së zhdredhjes zyrtare që ngjan në emërim të kandidatit për gjyqtar.

- Si gjyqtar në gjykatën themelore mund të zgjidhet gjyqtar nga një gjykatë tjetër themelore nëse nuk ka kandidatë të paraqitur nga Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë,

- Një kandidat i cili nuk është zgjedhur si gjyqtar, ka të drejtë të ankohet brenda tetë ditëve nga marrja e njoftimit për ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke i mundësuar llogaridhënie Këshillit gjyqësor dhe Gjykata supreme të përfshihen më shumë në zgjedhjen e gjyqtarëve. ,

- Në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarit në Gjykatën Administrative, janë forcuar kriteret për zgjedhjen e gjyqtarit sepse kjo Gjykatë do të zgjedh vetëm gjyqtarin që ka përfunduar trajnimin e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe ka të paktën katër vjet përvojë të vazhdueshme gjyqësore në gjykatën themelore deri në kohën e aplikimit për zgjedhje, dhe i cili është vlerësuar nga Këshilli Gjyqësor me vlerësim pozitiv. Me këtë hiqet zgjedhja e kaluar e cila parashikonte se për gjyqtarë të Gjykatës Administrative mund të zgjidhen persona të cilët kanë së paku pesë vjet stazh në shërbim juridik në një organ shtetëror, me rezultate të vërtetuara në punë,

- Një person i cili ka shërbyer të paktën një mandat si gjyqtar në një gjykatë ndërkombëtare dhe i cili përmbush kushtet, mund të jetë gjyqtarë i të gjitha niveleve.

Në periudhën raportuese u bë zgjedhje e një gjyqtari i Gjykatës Supreme nga sfera e krimit, dhe në tetor 2019, U zgjodhën tetë kryetarë të Gjykatave Themelore, përfshirë Gjykatën themelore Manastir me Gjykatën themelore Demir Hisar, Gjykatën themelore Veles, Gjykatën themelore Delçevë, Gjykatën Themelore Kërçovë me Njësinë në Makedonski Brod, Gjykatën Themelore Kriva Pallanka, Gjykatën themelore Prilep, Gjykatën themelore Civile Shkup dhe Gjykata themelore Shtip, si dhe dy gjyqtarë në Gjykatën Administrative. Duke pasur parasysh që shpalljet për këto zgjedhje janë botuar përpara ndryshimeve të reja legjislative, zgjedhjet e lartpërmendura janë bërë sipas kriterëve dhe procedurës së përzgjedhjes së mëparshme.

Një nga ndryshimet më të fundit legjislative të bëra në vitin 2019 deri në kohën e shkrimit të analizës, Këshilli Gjyqësor nuk përzgjedhi gjyqtarët për gjykatat themelore.

Është e qartë se ligjet e reja kanë shtrënguar kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe Gjykatën administrative. Baza teorike është e

vendosur mirë, por gjithashtu duke marrë parasysh që ende nuk ka emërim të gjyqtarëve në gjykatat themelore, as në Gjykatën Administrative sipas ligjit të ri, Nëse do të ketë përmirësim dhe cilësi të rritur në përzgjedhjen e gjyqtarëve do të tregojë zbatim praktik në të ardhmen.

Pjesa 3. Monitorimi dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve

3.1 Çfarë kanë sjellë reformat? - Analiza e kornizës ligjore

Qëllimi i vlerësimit profesional të funksionit gjyqësor është të avancojë cilësinë e drejtësisë gjyqësore. Kjo mund të arrihet duke rritur motivimin personal të gjyqtarëve dhe duke siguruar zhvillim profesional bazuar në aftësitë e tyre profesionale, kështu duke siguruar kushtet për promovimin e gjyqtarëve pa asnjë ndikim dhe duke rritur pavarësinë e gjyqtarëve në ushtrimin e detyrës së tyre gjyqësore. Rregullorja e mëparshme e vlerësimit të gjyqtarëve nuk parashikonte vlerësim objektiv të cilësisë në veprimet e gjyqtarëve dhe bazohej në kriteret që pasqyrojnë produktivitetin e gjyqtarëve përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Automatik të Gjykatës (AKMIS) Sistemi i tillë nuk merrte parasysh aspektet e nevojshme për të siguruar vlerësim real dhe gjithëpërfshirës të gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të tyre gjyqësor, siç janë aftësia për të argumentuar dhe arsyetuar vendimet, kompleksitetin e çështjeve, gatishmërinë për mbajtjen e seancave, etj, dhe nuk ofronte një vlerësim të përbushjes së kushteve për promovimin e gjyqtarëve. Për shkak të mungesës së një procedure të saktë për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare, Strategjia për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 parashikoi revidim të sistemit për monitorimin e performancës dhe vlerësimin e gjyqtarëve duke kombinuar **kritere cilësore dhe sasiore**.

Kriteret dhe procedura për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarit

Ndryshimet në ligjin e Këshillit Gjyqësor të majit 2018⁵³ prezantuan kritere të reja cilësore që Komisioni i Venecias i vlerësoi si të paqarta dhe pamjaftueshëm objektive, dhe ato u përsosën më tej me një Akt plotësisht të ri të Këshillit Gjyqësor 2019. Modeli i ri i vlerësimit të cilësisë për herë të parë parashikon një rol për gjyqtarët e gjykatave më të larta që do të vlerësojnë cilësinë e lëndëve individuale, në vend të Komisionit të përbërë nga Këshilli Gjyqësor. Vlerësimi i aspekteve të tjera (cilësore dhe sasiore) mbetet përgjegjësi e një komisioni tre anëtarësh të Këshillit Gjyqësor, i cili merr vendimin përfundimtar. Ligji nuk i përcakton qartë kompetencat e Këshillit në procesin e vlerësimit dhe parashikon metodë të kombinuar të votimit dhe vlerësimit me poena, që do të thotë se ata edhe më tej do të vazhdojnë të vlerësojnë në mënyrë subjektive sjelljen profesionale të gjyqtarëve.⁵⁴ Këshilli duhet të rregullojë detajet rreth procedurës së vlerësimit me Metodologjinë e Vlerësimit si akt nënligjor,⁵⁵ bazuar në mendimin e Gjykatës supreme të RMV si gjykata më e lartë dhe kompetente për funksionimin e gjykatave në vend. Këshilli mund të vlerësojë një gjykatës me notë "pozitive" mbi 100 pikë ose rezultat "negativ" nën 100 pikë.⁵⁶ Ndryshimet e reja ligjore në procedurën disiplinore ndryshuan edhe kushtet që gjyqtari mund të pushohet nga puna nga Këshilli Gjyqësor me dy vlerësime të njëpasnjëshme "negative". Meqenëse vlerësimi negativ

⁵³ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)

⁵⁴ Neni 80, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë) nr.106/19)

⁵⁵ Neni 82 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.106/19).

⁵⁶ Neni 89 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.106/19)

ndikon në cilësinë dhe afatin e duhur të punës, sipas ndryshimeve të reja në Ligjin për gjykatat, kjo situatë vlerësohet si kryerje joprofessionale dhe joetike e funksionit gjyqësor dhe paraqet një shkelje më të rëndë disiplinore.⁵⁷

Monitorimi i punës së gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës edhe më tej do të zhvillohet përmes vlerësimit në çdo katër vite dhe në raste të jashtëzakonshme vlerësimi në rastet kur promovohen gjyqtarët.⁵⁸ Rregullore e mëparshme⁵⁹ parashikonte vlerësim të rregullt në dy vite, që është vërejtur si një periudhë tejet e shkurtër për vlerësim dhe shkaktonte presion të vazhdueshëm mbi punën e gjyqtarëve dhe ndikonte në efikasitetin e tyre dhe në pavarësinë e vendimmarrjeve. Vlerësimi i jashtëzakonshëm në ligjin e vjetër u zhvillua sipas vlerësimit të Këshillit, dhe tani paraqet aspekt thelbësor për avancimin e gjyqtarëve dhe do të zbatohet në rastet kur konkurrohet për zgjedhje të gjyqtari të gjykatës më të lartë, për zgjedhje të kryetari të gjykatës ose anëtarit të Këshillit gjyqësor.⁶⁰ Për dallim nga rregullorja e mëparshme, nuk është e parashikuar që Këshilli të vlerësojë gjyqtarët e zgjedhur rishitazi në mënyrë të jashtëzakonshme. Risia kryesore është që vlerësimi kryesisht do të bazohet në kritere cilësore si bazë e rezultatit 60% të gjyqtarit ku gjyqtari mund të marrë 120 pikë, kundrejt kritereve sasiore që përbëjnë 40% të rezultatit total dhe për të cilat gjyqtari mund të marrë maksimumin 80 pikë. Vlerësimi i gjyqtarëve deri më tani është bazuar në kriteret sasiore, sipas të cilave gjyqtari mund të merrte maksimum 140 pikë për llogaritjen e suksesit në arritjen e numrit orientues të lëndëve që gjyqtari duhej ti zgjidhte në nivel mujor, dhe në lidhje me kriteret cilësore që gjithsesi e vlerësonin produktivitetin në veprim, gjyqtari mund të fitojë 3 pikë shtesë për punë profesionale të botuar ose materiale arsimore të përpunuara për përdorimin e Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë.⁶¹ Si pjesë e vlerësimit parashihet edhe pasqyrimi i kohës efektive të kaluar në punë.

Përveç vlerësimit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm të gjyqtarëve, Ligji për Këshillin Gjyqësor⁶² parashikon raste të veçanta për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, përkatësisht vlerësimin e një gjykatësi që nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes së një gjykate më të lartë (Gjykata Supreme e RMV-së) dhe vlerësim automatik pozitiv nëse konkurron një ish gjyqtar nga një gjykatë ndërkombëtare. Për dallim nga Ligji i mëparshëm, zgjidhja e re ligjore nuk ofron kritere shtesë dhe specifike në lidhje me ushtrimin e detyrës gjyqësore si pjesë e vlerësimit. Si pjesë e monitorimit të punës së gjyqtarëve, është paraparë që Këshilli të përgatisë model për të dhënat mbi punën e gjyqtarëve sipas kritereve të vlerësimit i cili plotësohet një herë në muaj, por nuk specifikohet se si dhe nëse ky formular do të jetë pjesë e vlerësimit të gjyqtarit.⁶³

Në bazë të raporteve nga komisionet, si dhe nga pasqyra e bërë për cilësinë dhe produktivitetin e veprimit, Këshilli sjell vendim me arsyetim të vlerësimit. Gjyqtari i vlerësuar/kryesuesi ka të drejtë të paraqesë ankesë brenda 8 ditëve për vendimin, dhe Këshilli

⁵⁷ Neni 76 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019).

⁵⁸ Neni 77 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.106/19)

⁵⁹ Ligji për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" nr.)60/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/17 dhe 83/18 ")

⁶⁰ Neni 77 paragrafi 2 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.106/19)

⁶¹ Neni 112, Kritere shtesë për ushtrimin e detyrës gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" nr.60/2006, 150/2010, 100/2011)

⁶² Neni 88 i Ligji për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.106/19) Kështu, nëse puna e gjyqtarit nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes së një gjykate më të lartë (Gjykata Supreme e RMV), pra nuk janë ngritur mjete juridike kundër vendimeve të tij, gjyqtari do të marrë një maksimum prej 105 pikësh sipas kritereve të përcaktuara në ligj dhe metodologjisë së vlerësimit .

⁶³ Neni 78 paragrafi 3 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.106/19)

do ta refuzojë, pranojë ose rivlerësojë atë. Dispozitat e tilla ligjore janë parashikuar në rregulloren e mëparshme, ndërsa si kompetent të veprorë pas ankesës për vendimin e marrë të Këshillit gjyqësor është Këshilli i Apelit në kuadër të Gjykatës supreme.⁶⁴

Kriteret cilësore

Dispozitat e mëparshme ligjore që përcaktonin kriteret cilësore nuk pasqyrojnë cilësinë e vërtetë të funksionit gjyqësor, por e vlerësonin marrëdhënien e gjyqtarit ndaj punës përmes shkallës së produktivitetit, gjegjësisht respektimit të afateve ligjore për ndërmarrje të veprimtarive procedurale, publikimin dhe përgatitjen e vendimeve dhe relacionit mes numrit të vendimeve të vërtetuara, të ndërprera ose të modifikuara në lidhje me lëndët e zgjidhura. Këto kriteret janë reviduar me ndryshimet ligjore të vitit 2018,⁶⁵ por Komisioni i Venecias vuri në dukje se vlerësimi i përmbushjes së tyre nuk ishte përcaktuar në mënyrë të qartë.

Ligji për Këshillin Gjyqësor në nenet 80 deri 85⁶⁶ përcakton kriteret kualifikuese për vlerësimin e një gjykatësi dhe mënyrën e pikësimit në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias të vitit 2019⁶⁷

- Cilësia e mbajtjes së procedurës gjyqësore të cilat vlerësohet: aftësia për të argumentuar, gatishmëria për të zhvilluar debat, përgatitje të procesverbalit dhe dëgjimin e palëve, gatishmëria për të marrë vendime procedurale si dhe aftësia për të zgjidhur konfliktet.

Vlerësimi i cilësisë së procedurave do të bëhet nga Komisioni i përbërë nga gjyqtarë nga gjykata më e lartë e menjëhershme, dhe atë përmes inspektimit të pesë lëndëve të zgjedhura rastësisht nga sistemi AKMIS, si dhe pesë lëndë të caktuara nga gjyqtari që vlerësohet. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve nga kolegët e tyre nga gjykatat më të larta ka për qëllim vlerësimin real të cilësisë së procedurave, në krahasim me procedurën e mëparshme kur vlerësimi është kryer nga një Komitet prej tre anëtarësh të Këshillit gjyqësor. Secili nga gjyqtarët-anëtarë të Komisionit do të propozojë vlerësim individual për secilin rast dhe do t'i paraqesë Këshillit vlerësim të ndërmjetëm me arsyetim.

- Cilësia e veprimit të shpejtë në lëndët gjyqësore në lidhje me: respektimin e afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale në procedurë, respektimin e afateve ligjore për marrjen, publikimin dhe hartimin e vendimeve, kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore;

⁶⁴ Neni 97, Përbërja e Këshillit për ankesa nuk ka ndryshuar, gjegjësisht përbëhet nga 9 anëtarë, tre gjyqtarë të Gjykatës Supreme, 4 gjyqtarë të Gjykatave të Apelit dhe dy gjyqtarë të gjykatës nga e cila vjen gjyqtari që bën ankimin. Nëse Këshilli Gjyqësor vendos të rivlerësojë, do të formohet Këshill prej tre anëtarësh nga radhët e Këshillit i cili do të përgatisë një raport dhe do të bëjë një rivlerësim. Në situata të tilla, gjyqtari / kryetari i trupit gjykues nuk ka të drejtë ankese.

⁶⁵ Neni 103- Kriteret kualifikuese për vlerësimin e punës së gjyqtarit janë: - cilësia e punës së gjyqtarit në pjesën e numrit të vendimeve të anuluar për shkak të shkeljes së ndjeshme të procedurës në lidhje me numrin e përgjithshëm të çështjeve normative të zgjidhura, - cilësinë e punës së gjyqtarit në pjesë. numri i vendimeve të kthyera në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendimeve të standardizuara të zgjedhura, - cilësinë e procedurave gjyqësore (respektimin e afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale në procedurë, respektimin e afateve ligjore për gjykimin, publikimin) është gjithashtu përgatitja e vendimeve, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore dhe respektimi i parimit të gjykimit brenda një kohe të arsyeshme), - cilësia e vendimit të marrë duke inspektuar pesë raste të rastit nga sistemi kompjuterik i automatizuar i administrimit të çështjeve gjyqësore dhe pesë raste të caktuara nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit dhe - shqiptohet një masë disiplinore. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)

⁶⁶ Ligji për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019),

⁶⁷ NORTH MACEDONIA OPINION ON THE DRAFT LAW ON THE JUDICI Adopted by the Venice Commission at its 118th Plenary Session (Venice, 15-16 March 2019)

Cilësia e veprimit të shpejtë i lëndëve gjyqësore do të vlerësohet duke inspektuar të dhënat e çështjeve të marra përmes AKMIS. Megjithëse bëhet fjalë për kriter cilësor, dispozitat ligjore parashikojnë vlerësime bazuar në përqindjen e afateve që lëvizin nga kohëzgjatja në respektimin e afateve në më pak se 50% të rasteve, dhe respektimi i afateve në më shumë se 90% në 100% të rasteve.

- Cilësia e punës së gjykatësit në pjesën e numrit të vendimeve të anuluar për shkak të shkeljes së konsiderueshme të procedurës në lidhje me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura të standardizuara.

Aspekti i vlerësimit të cilësisë së punës së gjyqtarit duhet të shtjellohet në detaje në Metodologjinë e vlerësimit. Ky kriter përcaktohet nga përqindja e vendimeve të anuluar për shkak të një shkelje të konsiderueshme të procedurës nga të dhënat e AKMIS.

Duke para sysh se cilësia do të vlerësohet përmes këqyrjes në procedurën gjyqësore dhe vendimmarrjes, Këshilli gjyqësor duhet ta revidojë **Metodologjinë me tregues të kompleksitetit të lëndëve** sipas fushës juridike, kompleksitetit të lëndës dhe llojit të gjykatave, si dhe në bazë të shkallës së kompetencës reale.⁶⁸ Përmes Metodologjisë është parashikuar të përcaktohet numri orientues i lëndëve që duhet të vendoset në muaj nga gjyqtari, gjatë kësaj duhet të marrë parasysh ngarkesa e punës dhe lloji i lëndëve për secilën gjykatë individuale. Roli i Gjykatës Supreme forcohet gjithashtu përmes këtij neni, për shkak se ai do të jetë kompetent për të dhënë mendimin e vet dhe për të miratuar Metodologjinë e seancës së përgjithshme të gjykatës.

Ligji gjithashtu parashikon kritere cilësore shtesë për vlerësimin e kryetarit të gjykatës i cili ka marrë përsipër detyrimin për gjykimin e lëndëve⁶⁹:

- Programi i realizuar për punë me planë veprim;
- Zbatimi i Rregullores së Punës së Gjykatës, e cila vlerësohet përmes këqyrjes së raporteve nga kontrollimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata më e lartë, Këshilli ose Ministria e drejtësisë;
- Funksionimi i AKMIS vlerësohet përmes këqyrjes së raporteve të kontrollimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata më e lartë, Këshilli ose Ministria e drejtësisë;
- Cilësia e vendimit të marrë në administratën gjyqësore

Cilësia e vendimit të marrë në administratën gjyqësore do të vlerësohet përmes krijimit të Komisionit prej pesë gjyqtarë direkt nga gjykata më e lartë. Komisioni do të vlerësojë çështjet në varësi të bazës ligjore, kuptueshmërisë dhe qartësisë së gjuhës, vallë ka argument për të gjitha faktet, rrethanat dhe provat.

- Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca e punës.

Ky kriter vlerësohet duke këqyru afatet e shpejtësisë së botimit të informacioneve në ueb faqen e gjykatës, përkatësisht nëse gjykata publikon njoftime, vendime, analiza dhe raporte.

⁶⁸ Neni 85 ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019),

⁶⁹ Neni 92 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019),

Kriteret sasiore

Ligji i mëparshëm për Këshillin Gjyqësor⁷⁰ si bazë e vlerësimit, të dhënat për numrin, llojin dhe numrin e çështjeve të zgjidhura në lidhje me numrin e çështjeve janë arritur përmes ACMIS. Megjithëse kriteret sasiore vazhdojnë të bazohen në informacionet dhe të dhënat e fituara nga AKMIS, ato duhet të jenë të harmonizuara me Metodologjinë me treguesit për kompleksitetin e llojeve të lëndëve për përcaktimin e llojeve të lëndëve kundër të cilave lejohen mjetet juridike. Një metodologji e tillë duhet të krijojë sistem të ri për përcaktimin e normës orientuese mujore. Ligji përcakton që një gjyqtar përbush plotësisht kriteret sasiore nëse ai / ajo përbushin normën 100% mujore për lëndët e zgjidhura.

Neni 86 i Ligjit për Këshillin gjyqësor parashikon kriteret sasiore:⁷¹

- Vëllimi i punës që vlerësohet përmes numrit dhe llojit të lëndëve të zgjidhura në lidhje me numrin orientues të lëndëve, të fituara nga raportet mujore nga AKMIS.
- Sasia e punës së gjyqtarit për sa i përket numrit të vendimeve të ndryshuara dhe të anuluar në lidhje me numrin e përgjithshëm të lëndëve standarde të zgjidhura vlerësohet përmes këqyrjes në AKMIS, duke marrë parasysh vetëm numrin e vendimeve kundër të cilave lejohen mjetet juridike dhe nëse ato janë të ndryshuara për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kryetari i gjykatës i cili ka marrë përsipër detyrën e gjykimit të lëndëve vlerësohet në bazë të të njëjtave kriteret sasiore për gjyqtarët, me atë që norma orientuese do të vlerësohet në 70%. Për më tepër, kur ai vlerësohet si kryetar i gjykatës, kriteret sasiore vlerësojnë produktivitetin në nivelin e gjykatës duke përcaktuar përqindjen e lëndëve të zgjidhura në lidhje me lëndët e pranuar në gjykatë.

3.2 Aplikimi i risive

Zbatimi i dispozitave të reja ligjore për sistemin e ri të vlerësimit duhet të rregullohet më tej me miratimin e akteve nënligjore nga Këshilli Gjyqësor i RMV. Ligji parashikon që Këshilli do t'i miratojë të gjitha aktet nënligjore brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, por edhe pas 6 muajve ato akoma nuk janë miratuar. Këshilli Gjyqësor, në pjesën e vlerësimit të gjyqtarëve, duhet të përgatisë:

- Udhëzimet dhe formular me të dhëna dhe informacione mbi punën e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës sipas kriterëve për vlerësim;
- Vendim për llogaritjen e kohës efektive për punën e gjyqtarëve;
- Monitorimi dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve
- Rregullore për punën e Komisionit për vlerësimin e cilësisë së mbajtjes së procedurës gjyqësore;
- Metodologjia e treguesve për kompleksitetin e lëndëve

Këshilli Gjyqësor gjithashtu duhet të ndryshojë Rregulloren për punë të Këshillit gjyqësor⁷² dhe të rregullojë mënyrën e miratimit të vendimeve për vlerësim, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit tre anëtarësh dhe ta përcaktojë mënyrën e arsyetimit dhe publikimit të vendimeve për vlerësime që nuk janë të rregulluara me ligj.

⁷⁰ Neni 102 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)

⁷¹ Ligji për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019),

⁷² Rregullorja e punës e Këshillit Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e RSM) nr. 60/06, 150/10, 100/11, 20/15, 61/15)

Edhe pos notave pozitive për Ligjin e ri,⁷³ mënyra e vlerësimit duhet të testohet dhe të rishikohet rregullisht pasi shumica e kriterëve përcaktohen me ligj dhe nuk janë plotësisht të harmonizuara me procedurat e tjera, siç është procedura për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe ngritjen e procedurave disiplinore. Për shembull, si kriter për zgjedhjen e gjyqtarit në një gjykatë më të lartë⁷⁴ është parashikuar miratim i vlerësimit pozitiv në punë, por edhe vlerësim të njohurive profesionale dhe specializimin në gjyqësor, pjesëmarrje në trajnime të vazhdueshme, ndërmarrje e punës shtesë në kryerjen e funksionit gjyqësor me pjesëmarrje në zgjidhjen e prapambetjeve, punë shtesë përmes mentorimit dhe edukimit etj. Këto aspekte nuk merren parasysh kur përcaktohen kriteret cilësore për vlerësimin e gjyqtarëve, dhe janë të rëndësishme për vlerësim objektiv të cilësisë së gjyqtarëve dhe ato duhet të specifikohen më tej në aktet nënligjore që do të miratohen nga Këshilli gjyqësor.

Në periudhën pasi Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe ndryshimet në Ligjin për Gjykatat e vitit 2019 hynë në fuqi, Këshilli Gjyqësor i RMV shpalli konkurs më 27.9.2019, nr.08-1548 / 2 dhe 08-1549 / 2 për zgjedhjen e kryetarëve të tri gjykatave të shkallës së parë dhe tre gjyqtarë të Gjykatës Supreme që duhet të zgjidhen në përputhje me kriteret e reja ligjore për zgjedhjen dhe vlerësimin e jashtëzakonshëm. Në zbatim të nenit 47 të Ligjit të për gjykatat, parashikohet që gjatë zgjedhjes së kryetarit të gjykatës, Këshilli të japë notë pozitive në bazë të sistemit të ri të vlerësimit të jashtëzakonshëm, duke treguar që cilësia e procedurave gjyqësore do të vlerësohet për herë të parë në periudhën në vijim.

Më 3.10.2019, Këshilli Gjyqësor i RMV-së zgjodhi 10 kryetarë të gjykatave themelore dhe të Lartë Administrative pas njoftimeve për konkursin e majit 2019, për të cilat nuk u zbatuan dispozitat për vlerësim të jashtëzakonshëm të gjyqtarëve për avancim në një gjykatë më të lartë dhe zgjedhjen e kryetarit të gjykatës. Vlerësimi i fundit i rregullt u zhvillua në maj-qershor 2019 dhe u krye sipas parashikimeve të Ligjit të vjetër për këshillin gjyqësor.⁷⁵

3.3 Konkluzione

Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor parashikon për herë të parë kriteret e qarta dhe objektive për vlerësimin e cilësisë së funksionit gjyqësor. Ndryshimet më të rëndësishme në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV dhe Ligjin për Gjykatat në lidhje me procedurën e vlerësimit të gjyqtarëve janë:

- Ligji parashikon kornizë solide për përmirësimin e sistemit të vlerësimit të punës së gjyqtarëve duke siguruar përparësi mbi kriteret cilësore mbi ato sasiore. Kjo qasje vlerësimi për herë të parë në thelb e vë në fokus cilësinë e drejtësisë gjyqësore duke vlerësuar argumentimin dhe kuptueshmërinë e vendimeve. Në këtë mënyrë sigurohet përmirësim i duhur i zhvillimit profesional dhe avancimit të gjyqtarëve.

- Kriteret për vlerësimin e cilësisë së procedurave gjyqësore dhe punën e gjykatësit duke përfshirë gjyqtarë që do të kryejnë vlerësimin sigurojnë vlerësim objektiv të punës së gjykatave. Vlerësimi do të përfshijë aspektet e vlerësimit të cilësisë, siç janë aftësitë profesionale, integriteti dhe përvoja, ekspertiza profesionale (njohuri e ligjit, aftësia për të udhëhequr procedura gjyqësore, aftësia për të shkruar gjykime të mirë të arsyetuara), aftësi personale (aftësia për ballafaqim me numrin e ndarë të lëndëve për procedim, aftësia për të

⁷³ Ligji për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19)

⁷⁴ Neni 48 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19)

⁷⁵ Ligji për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" nr.)60/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/17 dhe 83/18)

marrë vendime, i hapur ndaj adaptimit të teknologjive të reja), aftësi shoqërore, ose aftësia për të ndërmjetësuar, etj.

- Ndryshimet në Metodologjinë me treguesit për kompleksitet të lëndëve duhet të ndryshohet, pasi përcaktimi i normës orientuese ndikon në efikasitetin dhe cilësinë e procedimit të gjyqtarëve. Metodologjia duhet të krijojë sistem të ri të përcaktimit të normës orientuese bazuar në specifikën dhe kompleksitetin e lëndëve për secilën gjykatë individuale, fushat juridike dhe kompetencat reale të gjykatës.

Pjesa 4: Zgjedhja e gjykatësit në gjykatë më të lartë dhe kryetar të gjykatës

4.1 Çfarë sollën reformat? -Analiza e kornizës ligjore

Në kornizat e kompetencave të saj për zgjedhjen e gjykatësve, Këshilli gjyqësor zgjedhe edhe gjykatës në gjykata më të larta, në Gjykatën e Apelit, në Gjykatën e Lartë Administrative dhe në Gjykatën Supreme të RMV, si dhe kryetarë të gjykatave. Zgjedhja bëhet nga kandidatët e paraqitur në konkurs që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në Ligjin për gjykata dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV ashtu që kandidatët e paraqitur i rangon sipas specializimit për plotësimin e vendit gjyqësor.⁷⁶

Zgjedhja e gjykatësve në gjykatë më të lartë

Këshilli për gjykatës do të zgjedhë person i cili ka kualifikime më të larta profesionale i cili gëzon reputacion në kryerjen e funksionit gjyqësor ndërsa në bazë të kriterëve në vijim:

- njohje profesionale dhe specializim në profesionin dhe pjesëmarrje në trajnim të vazhdueshëm,
- vlerësim pozitiv për punën,
- aftësi për shprehje me gojë dhe me shkrim, që shihet nga vendimet e përpiluara dhe veprimin gjyqësor profesional,
- pranimi i punës plotësuese në ushtrimin e funksionit gjyqësor me pjesëmarrje në zgjidhjen e lëndëve të vjetra,
- pranimi i punës plotësuese gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor nëpërmjet monitorimit, edukimit dhe ngjashëm dhe
- kohëzgjatja e stazhit gjyqësor.⁷⁷

Nëse kandidati është nga radhët e gjykatësve, Këshilli gjyqësor siguron mendim nga gjykata në mënyrë që kryetari i gjykatës, në bazë të mbledhjes së mbajtur të gjykatësve, e dorëzon mendimin te Këshilli.

Kushte të veçanta për zgjedhjen e gjykatësit në Gjykatë të apelit janë:

- gjykatës në gjykatën e apelit mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune të paktën gjashtë vjet stazh të pa ndërprerë si gjykatës në gjykatë themelore, Gjykatë administrative ose Gjykatë të lartë administrative deri në momentin e paraqitjes së zgjedhjes, që nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar si notë pozitive në pajtim me Ligjin për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë,

⁷⁶ Neni 48 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të R.M ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 60/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)

⁷⁷ ibid

- gjykatës në gjykatën e apelit mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune të paktën katër vjet stazh të pa ndërprerë si gjykatës në gjykatë tjetër të apelit deri në momentin e paraqitjes së zgjedhjes, që nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar si notë pozitive në pajtim me Ligjin për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë,⁷⁸

Kushte të veçanta për zgjedhjen e gjykatësit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë:

- gjykatës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune të paktën gjashtë vjet stazh të pa ndërprerë si gjykatës në gjykatë të apelit deri në momentin e paraqitjes së zgjedhjes, që nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar si notë pozitive në pajtim me Ligjin për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë⁷⁹.

Kushte të veçanta për zgjedhjen e gjykatësit në Gjykatën e Lartë Administrative, janë:

- gjykatës në Gjykatën e Lartë Administrative mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune të paktën gjashtë vjet stazh të pa ndërprerë si gjykatës në Gjykatë e Apelit ose në Gjykatën administrative deri në momentin e paraqitjes së zgjedhjes, që nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar si notë pozitive në pajtim me Ligjin për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë⁸⁰.

Zgjedhja e kryetarit të gjykatës

Kryetari i gjykatës ka status dhe funksion të gjykatësit të parë në mesin e të barabartëve në gjykatën përkatëse.

Këshilli gjyqësor e realizon edhe procedurën për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, e cila fillon me shpalljen e konkursit dy muaj para skadimit të mandatit të kryetarit aktual⁸¹.

Neni 47 i Ligjit për gjykatat me ndryshimet parashikon se kryetari i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjykatësve të cilët kanë të paktën gjashtë vjet stazh gjyqësor të pa ndërprerë në gjykatë të shkallës së njëjtë ose më të lartë, nën kushtet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj, për kohë prej katër vjet, me të drejtë edhe për një zgjedhje në gjykatën e shkallës së njëjtë⁸².

Nga kandidatët e paraqitur, të cilët i plotësojnë kushtet e nevojshme, Këshilli gjyqësor i RMV ë së voni dy muaj para shpalljes së konkursit zgjedh kryetar të gjykatës.

Kandidati për kryetar të gjykatës bashkë me fletëparaqitjen dhe dokumentet të tjera paraqet edhe programe për punë gjatë mandatit me plan veprim për zbatimin e programit⁸³.

Në rast të ndërprerjes së mandatit të kryetarit të gjykatës ose në rast të shkarkimit të tij, Këshilli gjyqësor përcakton ushtrues detyre kryetar nga radhët e gjykatësve të gjykatave, i cili është vlerësuar me notën më të lartë pozitive dhe ka numër më të madh të pikëve.

⁷⁸ Neni 46 paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

⁷⁹ Neni 46 paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.) 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

⁸⁰ Neni 46 paragrafi 2 ibid

⁸¹ Neni 47 ibid

⁸² Ibid.

⁸³ Ibid.

Në lidhje me vlerësimin pozitiv, vlerësimi i rregullt i gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës kryhet një herë në katër vjet, përfshirë muajin qershor të vitit rrjedhës, për punën e gjykatësve dhe kryetarit të gjykatës në katër vitet e kaluara.

Në rastin kur gjykatësi konkurren për zgjedhje të gjykatësit në gjykatë tjetër, në gjykatë më të lartë ose për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, bëhet vlerësim i jashtëzakonshëm për punën e gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës.

Nëse gjykatësi ose kryetari i gjykatës konkurrojnë për gjykatës në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës, në vitin rrjedhës për vitin e kaluar, për të cilin janë vlerësuar nëpërmjet vlerësimit të rregullt në atë raste nuk bëhet vlerësimi i tyre i jashtëzakonshëm⁸⁴.

Për realizimin e rregullt të procedurës së zgjedhjes së gjykatësve në gjykata më të larta, Këshilli gjyqësor formon komision prej tre anëtarë të zgjedhur e anë të hedhjes së short, ⁸⁵ që i kontrollojnë dokumentet e kandidatëve, e përpilon listën, i njofton kandidatët për ditën dhe orën e realizimit të testit psikologjik dhe testit të integritetit dhe për kompensimin financiar për ato teste që janë në barë të kandidatëve, realizon intervista me kandidatët të cilët i kanë kaluar testet dhe përpilon rang listën përfundimtare sipas specializimit të nevojshëm, si dhe rang listë të kandidatëve të cilët nuk kanë nevojë për specializim.

Këshilli gjyqësor zgjedh kryetar të gjykatës nga kandidatët e paraqitur gjykatës në konkursin për zgjedhjen e kryetarit me procedurën e njëjtë për zgjedhjen e gjykatësit në gjykatë themelore. Këshilli gjyqësor vendos me të paktën tetë anëtarë të Këshillit me të drejtë vote dhe secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote është i obliguar në seancë të Këshillit me gojë të arsyetojë vendimin e tij për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës.

Çdo kandidat do të njoftohet me shkrim për vendimin e kryetarit të gjykatës dhe kandidati i cili nuk është zgjedhur kryetar i gjykatës ka të drejtë për ankesë në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të njoftimit të Këshillit për vendimmarrje për ankesa pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut⁸⁶.

Nëse Këshilli gjyqësor në seancë përcakton se në konkurs nuk është paraqitur asnjë kandidat ose asnjë nga kandidatët e paraqitur nuk i plotëson kushtet ligjore për zgjedhje publikon konkurs të ri për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës në afat prej dhjetë ditë nga dita kur e ka konstatuar gjendjen.

Kryetari i gjykatës i cili nuk do të zgjidhet përsëri në funksionin e njëjtë vazhdon të punojë si gjykatës në gjykatën në të cilën e ka ushtruar funksionin gjyqësor.⁸⁷

Siç u përmend, personi i cili të paktën një mandat ka qenë gjykatës në gjykatë ndërkombëtare dhe i cili i plotëson këto kushte, mund të zgjidhet gjykatës në të gjykatat e të gjitha shkallëve.

Është garantuar përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në zgjedhjen e gjykatësve, kështu kryetari i gjykatës themelore dhe gjykatës së Apelit i cili gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, gjatë çka duhet të ketë shumicë të votave nga anëtarët të cilët u takojnë komuniteteve jo shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

⁸⁴ Neni 77 i Ligjit për Këshillin gjyqësor të RMV

⁸⁵ Neni 48 ibid

⁸⁶ Neni 51 i Ligjit për Këshillin gjyqësor

⁸⁷ Ibid.

Kur Këshilli Gjyqësor zgjedh kryetar dhe gjykatës të Gjykatës Administrative, të Gjykatës së Lartë Administrative dhe Gjykatës së Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të cilët u takojnë bashkësive jo shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁸⁸

4.2 Aplikimi i risive

Më 7.2.2019, në seancën e 297-të të Këshillit gjyqësor u mor Vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e kryetarëve në Gjykatën Themelore Manastir, Gjykatën Themelore Veles, Gjykatën Themelore Dellçevë, Gjykatën Themelore Kavadar, Gjykatën Themelore Kërçovë, Gjykatën Themelore Kriva Pallankë, Gjykatën Themelore Negotinë, Gjykatën Themelore Prilep, Gjykatën Themelore Shkup - Shkup, Gjykatën Themelore Shtip.

Konkurset për zgjedhje janë publikuar më 22 maj, disa ditë para hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për gjykatat, gjatë çka për zgjedhjen e këtyre kryetarëve vlejné zgjidhjet e vjetra ligjore, përkatësisht ndryshimet dhe plotësimet nga viti 2018.

Zgjedhja e kryetarit u bë në tetor. Në seancën e 320-të, të Këshillit gjyqësor të mbajtur më 2.10.2019, u zgjodhën 8 kryetarë të gjykatave themelore, kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative dhe në mënyrë plotësuese dy gjykatës nga Gjykata Administrative.

Në shkurt 2019, Këshilli gjyqësor gjithashtu morri vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e gjashtë gjykatësve në Gjykatën e Apelit Shkup, si vijon: tre gjykatës për fushën penale, dy gjykatës për fushën civile, një gjykatës për kontestet tregtare. Zgjedhja e gjashtë gjykatësve të Gjykatës së Apelit Shkup, që duhej të kryhet është prolonguar dhe gjashtë gjykatësit ende nuk janë zgjedhur.⁸⁹

4.3 Konkluzione

Një nga qëllimet kryesore të Ligjit të ri për Këshillin gjyqësor të RMV dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat ishte veprimi në lidhje me rekomandimet për ri përkufizimin e kushteve për zgjedhjen e gjykatësve në gjykatë më të lartë, përkatësisht, rregullimin e mënyrës së zgjedhjes së gjykatësit në gjykatë më të lartë dhe përcaktimin e sistemit të vlerësimit të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, aspekte të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë.

Përpos stazhit të përcaktuar me ligj, për gjykatës në gjykata më të larta dhe për kryetar të gjykatës, duhet personi edhe të jetë vlerësuar me notë pozitive nga Këshilli Gjyqësor. Zgjidhjet e reja ligjore përfundimisht i saktësojnë kriteret sipas së cilave vlerësohen gjykatësit gjatë avancimit të tyre, gjatë çka raporti i kriterëve cilësore është rritur dukshëm në krahasim me kriteret kuantitative për çka në detaje flitet në Pjesën 3 të analizës.

Edhe pse nga hyrja në fuqi e zgjidhjeve të reja ligjore ishte bërë zgjedhja e gjykatësve në gjykatat më të larta dhe e kryetarëve të gjykatave, kjo zgjedhje është bërë në bazë të ligjit paraprak për shkak se konkurset për zgjedhjen e tyre janë publikuar para hyrjes në fuqi të ligjeve të reja.

Ligjet e reja i përforcojnë kriteret për zgjedhjen e gjykatësve në gjykata më të larta dhe kryetarë të gjykatave që duhet të kontribuojë për zgjedhjen më cilësore dhe më objektive, por

⁸⁸ Neni 50 ibid

⁸⁹ Nga aplikacioni “Këshilli gjyqësor nën thjerrëz” – Procesverbal nga seanca e Këshillit gjyqësor të RMV

duhet në mënyrë praktike të zbatohen kriteret e reja për zgjedhje dhe mënyra e re e vlerësimit, që të përcaktohet shkalla e harmonizimit dhe nevoja e rishikimit.

Pjesa 5: Përgjegjësia disiplinore

5.1 Çfarë sollën reformat? -Analizë e kornizës ligjore

Shënime hyrëse

Një nga qëllimet strategjike të Strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë 2017 – 2022 (në tekstin në vijim Strategjia) ka të bëjë me **përgjegjësinë** e organeve të drejtësisë⁹⁰. Duke u nisur nga nevoja për reforma të sistemit për përgjegjësi të gjykatëse, Strategjia identifikon një drejtim strategjik⁹¹. Si masë⁹² për realizim, Strategjia parashikoi intervenim në Ligjin për gjykata dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor në drejtim të: *1. Përforcimit të përgjegjësisë disiplinore të gjykatësit nëpërmjet saktësisë të qartë të bazave për shkarkim të gjykatësit me përcaktimin vetëm të shkeljeve më të rënda disiplinore si bazë për shkarkim, dhe 2. Të dhëna kuantitative siç janë përqindja e vendimeve të anuluar ose të ndryshuara të paraqesë bazë për përgjegjësi të gjykatësit, por jo edhe bazë për shkarkimin e gjykatësit.* Përpos kësaj, si masë për reformimin e sistemit për përgjegjësi disiplinore të gjykatësve, Strategjia parashikoi edhe abrogimin⁹³ e Ligjit për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Inicimin e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit dhe ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor në drejtim të kthimit të kompetencës për inicimin dhe mbajtjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë.

Shkaqet për të cilat duhej reformimi i sistemit për përgjegjësi të gjykatësve ishin identifikuar me detaje dhe janë analizuar si nga trupat kombëtare ashtu edhe nga trupa ndërkombëtarë. Problemet gjatë zbatimit të rregullave për përgjegjësi disiplinore ishin shënuar disa herë në raportet për progresin e RM-së ndaj BE-së, të ashtu quajturat, Raporte të *Pribe*, mendimet e Komisionit të Venecias dhe aktvendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pika fillestare në reformimin e sistemit ishin rekomandimet e dhëna në mendimin e Komisionit të Venecias për ligjet për përgjegjësi disiplinore dhe vlerësimin e gjykatësve për vitin 2015⁹⁴ të cilat ndër të tjerat përfshijnë:

- Ligjet të sigurojnë se gjykatësit nuk do të dënohen për situata të cilat janë jashtë kontrollit të tyre dhe të cilat mund të sqarohen me mos funksionimin e sistemit gjyqësor; Masat disiplinore nuk duhet të ngatërrohen me pavarësinë e gjykatësit gjatë vendimmarrjes dhe ato asnjëherë nuk duhet të vlejnjë për dallimet në interpretimin juridik të së drejtës ose gabimet gjyqësore.
- Vetëm keqpërdorimi i qëllimshëm i praktikës gjyqësore ose përsëritja e mos kujdesit të madh duhet të konsiderohet si shkelje disiplinore; sistemi i dënimeve duhet të jetë më pak drakonik për shkelje më të vogla, shkarkimi i gjykatësit mund të urdhërohet vetëm në raste jashtëzakonisht serioze;

⁹⁰ Qëllimi strategjik 2.3

⁹¹ Udhëzimi strategjik 2.3.1. Mekanizma funksionale për përgjegjësi të gjykatësve dhe prokurorëve publik, vendosja e kriterëve objektive dhe të matshme për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësve dhe prokurorëve publik, pluralizimi i sanksioneve, shkarkimi vetëm për shkelje më të rënda dhe të vazhdueshme disiplinore”

⁹² Masa nr. 2.3.1-1.

⁹³ Masa nr. 2.3.2-2.

⁹⁴ Opinion on the Laws on the Disciplinary Liability and Evaluation of Judges of "The Former Yugoslav Republic of Macedonia", adopted by the Venice Commission at its 105th Plenary Session (Venice, 18-19 December 2015).

- Funkcioni i Këshillit për Përcaktimin e Fakteve duhet të ri vendoset në Këshillin Gjyqësor me atë që anëtarët ose trupat e Këshillit gjyqësor të përfshirë në fazën fillestare të procedurës disiplinore si “prokurorë” ose “hetues” mos marrin pjesë në vendimmarrje si “gjykatës”...;
- Këshilli për ankesa (në lidhje me masën disiplinore) duhet të ndryshohet nga trupi gjyqësor, të përcaktuar me ligj. Vlerësimi i gjykatësve duhet të veçohet nga procedurat disiplinore;
- Mos realizimi i normave të punës, me automatizëm nuk guxon të barazohet me shkeljen disiplinore...;

5.2 Përshkrim i reformave të aplikuara

Karakteristike për reformimin e sistemit për përgjegjësi të gjykatësve është se nuk është realizuar përnjëherë, por në tre faza / valë. Shkaqet për këtë qëndrojnë në kompleksitetin e çështjes, urgjencën e segmenteve të caktuara të çështjes, nevojën për konsultim dhe përfshirjen e më tepër palëve të interesuara si dhe përfshirjen dhe konsultimin e Komisionit të Venecias në procesin e miratimit të ligjeve.

a. Vala e parë e reformave (dhjetor 2017 dhe janar 2018)

Vala e parë e reformave u realizua gjatë periudhës dhjetor 2017 dhe janar 2018 me ndryshime dhe plotësime të LGJRM⁹⁵ dhe abrogimin e Këshillit për përcaktimin e fakteve⁹⁶. Si reforma me rëndësi të veçantë të cilat u zbatuan në këtë fazë duhen theksuar këto:

- Pushtoi së ekzistuari Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Inicimin e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë së gjykatësit⁹⁷ dhe obligimi të iniciojë dhe mbajë procedura disiplinore u kthye te Këshilli Gjyqësor i RM-së.
- U vazhduan afatet gjatë së cilave mund të ngrihet kërkesë për inicimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë edhe atë në afatin subjekti prej tre në gjashtë muaj, ndërsa te afati objektiv nga një në tre vjet⁹⁸.
- Në drejtim të rritjes së transparencës u dha mundësia, me kërkesë të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, Këshilli të vendosë procedura të jetë publike. Me kërkesë të tyre, gjatë seancës mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i Shoqatës së Gjykatësve⁹⁹.
- Çështje të caktuara të cilat paraprakisht ishin lëndë e rregullimit të Rregullores u rregulluan me Ligj (përmbajtja e kërkesës, dërgimi, grumbullimi i të dhënave, diskutimi në lidhje me kërkesën, procesverbali etj.)¹⁰⁰.
- Me qëllim garantimin e paanshmërisë u parashikua formimi i Komisionit me tre anëtarë të Përcaktimin e Përgjegjësisë me hedhjen e shortit nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor si dhe baza për përjashtimin nga procedura (nëse anëtari i zgjedhur është parashtrues i kërkesës). Në mënyrë plotësuese, nëse përcaktohet përgjegjësia e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës i cili është pjesë e bashkësive jo shumicë, një anëtar i Komisionit

⁹⁵ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e RM-sw”, nr. 197 të datës 29.12.2017)

⁹⁶ Ligji për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit (“Gazeta Zyrtare e R. Së Maqedonisë”, nr. 11 të datës 18.01.2018)

⁹⁷ Neni 1 i Ligjit për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit (“Gazeta Zyrtare e R. Së Maqedonisë”, nr. 11 të datës 18.01.2018)

⁹⁸ Neni 54 të Ligjit për Këshillin gjyqësor.

⁹⁹ Neni 54 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit për Këshillin gjyqësor.

¹⁰⁰ Neni 55 dhe nenet 56-a deri në 56-zh.

duhet të jetë përfaqësues i bashkësive të cilat nuk janë shumicë. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga votimi në Këshill.¹⁰¹

b. Vala e dytë e reformave (maj 2018)

Në valën e dytë të reformave, përpos ndryshimit dhe plotësit, përsëri të dispozitave të cilat e rregullojnë procedurën,¹⁰² lëndë e ndryshimeve shin edhe dispozitat materiale¹⁰³ të parashikuara me Ligjin për gjykatat, të cilat janë në lidhje me llojet e shkeljeve disiplinore si dhe masat disiplinore. Me ndryshimet e Ligjit për Këshillin gjyqësor nga maji i vitit 2018 u vendos kjo risi:

- Në vend të Këshillit, anëtar i Këshillit – referues vlerëson nëse kërkesa është e parashtruar në kohë dhe e plotë, ndërsa mënjanohet obligimi për vlerësimin e lejes për kërkesë¹⁰⁴.
- Vendoset kusht plotësues, gjatë formimit të Komisionit të mbahet llogari për përfaqësimin e pjesëtarëve të zgjedhur si nga Këshilli nga radhët e gjykatësve, ashtu edhe nga Kuvendi i RMV.
- Kur anëtar i Këshillit është parashtrues i kërkesës për procedurë disiplinore jo vetëm që nuk merr pjesë në votim, por edhe nuk merr pjesë në diskutimin në Këshill.¹⁰⁵
- Vendoset obligimi anëtarët e Këshillit për Vendimmarrje për Ankesa të zgjidhen publikisht, sipas sistemit të tërheqjes së shortit, në seancë të përgjithshme, në afat prej 10 ditë nga pranimi i ankesës¹⁰⁶.
- Vendoset dhe rregullohet procedura për përsëritjen e procedurës në rast të vendimit nga GjEDNj¹⁰⁷.

Në lidhje me rregullimin e shkeljeve disiplinore dhe llojet e masave disiplinore, me ndryshimet e **Ligjit për gjykatat** nga muaji maj i vitit 2018, u parashikua:

- Në drejtim të rregullimit të qartë të shkeljeve më të rënda disiplinore të cilat mund të jenë bazë për shkarkim, u rrit numri i shkeljeve më të rëndë disiplinore nga 4 në 9 me çka u saktësuan rastet kur gjykatësi mund të shkarkohet nga funksioni dhe u vendosën 7 shkelje më të rënda disiplinore, ndërsa 2 shkelje ngelën nga versioni i mëparshëm i Ligjit (shkelje më e rëndë e rendit dhe paqes publike me të cilën rrënohet reputacioni i gjykatës dhe reputacioni i tij të përcaktuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm dhe arritja e notës së dobët gjatë dy vlerësimeve të rregullta të njëpasnjëshme)
- U shlye dispozita sipas së cilës si punë jo profesionale dhe e pa ndërgjegjshme do të merret parasysh edhe përqindja e vendimeve të anuluar dhe ndryshuara.
- Shkelje më e rëndë e të drejtave të palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë gjatë procedurës me çka cenohet reputacioni i gjykatës dhe funksionit gjyqësor dhe shkelja e parimit të jo diskriminimit mbi çdo bazë, nuk janë më bazë për shkarkim.
- Në lidhje me shkeljet disiplinore për të cilat mund të shqiptohet masë disiplinore u vendos shkelja e rregullave të kodit të etikës gjyqësore si shkelje.

¹⁰¹ Neni 60 i LGJRM.

¹⁰² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.83 të datës 8.5.2018)

¹⁰³ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 83 të datës 8.5.2018)

¹⁰⁴ Neni 56, paragrafi 1 i LGJRM.

¹⁰⁵ Neni 60, paragrafi 4 i LGJRM.

¹⁰⁶ Neni 96 i LGJRM.

¹⁰⁷ Neni 97 i LGJRM.

v. Vala e tretë e reformave (maj 2019)

Me valën e tretë, dhe tani për tani të fundit, të reformave në legjislacionin i cili e rregullon punën e gjykatave dhe Këshillit Gjyqësor të RMV, ndërsa ka të bëjë edhe me përgjegjësinë e gjykatësve u mbyllën reformat në këtë fushë. Ligji për gjykatat përsëri pësoi ndryshime¹⁰⁸ nga të cilat, me rëndësi të veçantë duhet të theksohen:

- Parashikimi i kushteve plotësuese të cilat duhet të plotësohen në rastet e shkarkimit të gjykatës përpos ekzistimit të bazave për shkarkim¹⁰⁹. Sipas këtyre kushteve të cilat në mënyrë përmbledhëse duhet të plotësohen, gjykatësi shkarkohet nëse shkelja është kryer me qëllim ose nga pakujdesia e evidente për faj të gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme dhe shkelja ka shkaktuar pasoja të rënda¹¹⁰.
- Zvogëlimi i numrit të shkeljeve më të rënda disiplinore, për dallim nga ndryshimi i vitit 2018, me të cilën numri i shkeljeve disiplinore, për të cilat është ngritur procedurë për shkarkim, u zvogëlua nga 9 në 4, nga të cilat vetëm një shkelje e parashikuar në tekstin paraprak ngeli të konsiderohet si e rëndë (shkelje më e rëndë e rendit dhe paqes publike dhe forma të tjera më serioze të sjelljes së a hijshme me të cilën cenohet reputacioni i gjykatës dhe reputacioni i tij)¹¹¹,
- Te shkeljet disiplinore për të cilat mund të shqiptohet masë disiplinore, u zvogëlua numri i shkeljeve disiplinore dhe gjatë vendimmarrjes vallë do të shqiptohet masa disiplinore, duhet të merren parasysh edhe kushtet në vijim: Shkelja disiplinore të jetë kryer me qëllim ose nga pakujdesia e evidente për faj të gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme dhe shkelja disiplinore të shkaktojë pasoja të rënda.¹¹²

Në maj të vitit 2019, për shkak të vëllimit të konsiderueshëm të tekstit aktual, u miratua Ligj tërësisht i ri për Këshillin Gjyqësor të RMV¹¹³. Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore rregullohet në mënyrë plotësuese me zgjidhjet e mëparshme, mirëpo në raport me çështje të caktuara vendos disa risi plotësuese të cilat janë në lidhje me:

- Jepet mundësi kërkesë për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetar të gjykatës të paraqesë cili do person, për dallim nga zgjidhja e mëparshme sipas së cilës kërkesën mund ta paraqesë anëtar i Këshillit Gjyqësor, kryetar i gjykatës, kryetar i gjykatës më të lartë ose seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme.
- Në vend anëtar i Këshillit – referues, kërkesën fillimisht e shqyrton Komisioni i referuesve, e formuar më anë të heqjes së shortit nga tre anëtarë, nga të cilët dy janë zgjedhur nga radhët e gjykatësve, ndërsa një nga anëtarët e Këshillit i zgjedhur nga Kuvendi. Komisioni ka autorizim me konsensus të refuzojë kërkesën nëse: nuk ka arritur në kohë, nuk është e plotë ose e evidente e pa bazuar, përkatësisht ka të bëjë me fakte të cilat mund të kenë qenë lëndë e shqyrtimit nga gjykatë më e lartë në procedurë për mjet juridik ose mund të kenë qenë lëndë e shqyrtimit nga gjykatë më e lartë, por nuk janë iniciuar me mjet juridik.
- Në diskutimin në lidhje me kërkesën nuk thërret parashtuesi i kërkesës.¹¹⁴

¹⁰⁸ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 96 të datës 17.5.2019)

¹⁰⁹ Shih neni 74 paragrafi 1 i Ligjit për gjykatat, Gjykatësi shkarkohet nga funksioni gjyqësor:

- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën të pa denjë për ushtrimin e funksionit gjyqësor të përcaktuar me ligj
- për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor nën kushtet e përcaktuara me ligj.

¹¹⁰ Neni 74 paragrafi 3 i Ligjit për gjykatat.

¹¹¹ Megjithatë këtu duhet përmendur se është hequr pjesa e dispozitës e cila kërkon shkelja të përcaktohet me vendim gjyqësor të plotfuqishëm.

¹¹² Neni 74 i Ligjit për gjykatat.

¹¹³ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102 të datës 22.5.2019)

¹¹⁴ Neni 66 paragrafi 2 i Ligjit për KGJRMV

- Kryetari dhe anëtarët e Komisionit vendosin gjatë diskutimit dhe votojnë për vendimin¹¹⁵.

5.3 Procedura për përcaktimin e përgjegjësishë gjatë periudhës nga viti 2017 deri në vitin 2019

Paralelisht me procesin e reformave, Këshilli Gjyqësor i RMV ka vepruar në lidhje me procedura për përcaktimin e përgjegjësishë së gjykatësve.

Në vitin 2017, Këshilli Gjyqësor veproi në lidhje me 7 (shtatë) kërkesa për inicimin e procedurës për përcaktimin e ushtrimit të funksionit të gjykatësit në mënyrë jo profesionale dhe të pa ndërgjegjshme, të paraqitura nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve. Për 2 (dy) kërkesa, të paraqitura në vitin 2016, Këshilli i refuzoi, njërin si të pa bazuar, ndërsa tjetra si e pa lejueshme. Në një nga procedurat është konstatuar veprim jo profesional dhe i pa ndërgjegjshëm, një njërin është ndërprerë ndërsa në të tjerat procedura ka qenë në rrjedhë.¹¹⁶

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përcaktimin e përgjegjësishë për gjykatës ose kryetar të gjykatës. Gjatë vitit 2018 janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përcaktimin e përgjegjësishë për gjykatës ose kryetar të gjykatës. 1 (një) gjykatës i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, 1 (një) gjykatës i Gjykatës Themelore Ohër, 1 (një) gjykatës i Gjykatës Themelore Prilep, 3 (tre) gjykatës të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, 1 (një) gjykatës i Gjykatës Themelore Kumanovë dhe 3 (tre) gjykatës të Gjykatës së Apelit Shkup.

Nga 3 (tre) kërkesa të cilat janë paraqitur në gjysmën e parë të vitit 2018, janë formuar Komisione nga të cilat për 1 (një) kërkesë është hartuar Raport me propozim - vendim nga Komisioni. 4 (katër) kërkesat të tjera janë paraqitur në tremujorin e fundit të vitit 2018 dhe ato u janë dërguar anëtarëve të Këshillit - referues.

Gjatë vitit 2018, Këshilli veproi në lidhje me 5 (pesë) kërkesa të paraqitura në vitin 2017, nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve në një procedurë është konfirmuar vendimi për shkarkim, në dy janë hartuar raporte me propozim vendime, ndërsa në të tjerat dy hetimi është në rrjedhë.¹¹⁷

Për vitin 2019, të dhënat ende nuk janë të plota. Është miratuar Aktvendim për shkarkimin e gjykatësit për shkak të ushtrimit të funksionit gjyqësor në mënyrë jo profesionale dhe të pandërgjegjshme. Një gjykatës është larguar përkohësisht nga ushtrimi i funksionit, sepse kundër tij prokuroria ka paraqitur akuzë për kurdishjen e lëndëve në AKMIS sistemin. Janë formuar komisione për përcaktimin e përgjegjësishë së gjykatësit ose të kryetarit të gjykatës për më shumë kërkesa në këtë periudhë. Disa nga kërkesat janë tërhequr nga referuesi i gjykatës. Është marrë vendim me të cilin ndërpritet procedura dhe vendime me të cilat kërkesa të caktuara refuzohen s jo të arritura në kohë dhe jo të plota. Është miratuar aktvendim me të cilin ndërpritet procedura për përcaktimin e përgjegjësishë për shkak të mos pasjes së bazës për përgjegjësi. Është marrë vendim me të cilin një kërkesë për përcaktimin e përgjegjësishë së gjykatësit është refuzuar s e arritur jo në kohë dhe e pa plotë¹¹⁸.

¹¹⁵ Neni 68 paragrafi 2 i Ligjit për KGJRMV

¹¹⁶ Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017

¹¹⁷ Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017

¹¹⁸ Instituti për të Drejtat e Njeriut. Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor të RMV, Raporti numër 4 (periudha e raportimit: Maj – gusht, 2019).

5.4 Konkluzione

Dispozitat të cilat e rregullojnë përgjegjësinë e gjykatësve në periudhë kohore relativisht të shkurtë (nga dhjetori i vitit 2017 deri në maj të vitit 2019) ishin lëndë e reformave të bëra me dy ndryshime dhe plotësime, ndërsa më pas edhe me Ligj tërësisht të ri për Këshillin Gjyqësor të RMV, si dhe dy ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykatat. Intervenimet e shpeshta në rregullat esenciale të cilat i rregullojnë bazat dhe procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatave sipas rregullit nuk kontribuojnë në drejtim të përcaktimit të sigurisë juridike. Megjithatë, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për proces reformues, më tepër intervenime deri diku mund edhe të arsyetohen me nevojën për zbatim më të shpejtë të reformave për çka shpesh herë nuk mund të kryhen analizat e nevojshme të patjetërsueshme gjatë kryerjes së reformave në këtë formë.

Ndryshimet dhe plotësimet e miratuara në lidhje me bazat për përgjegjësi në masë të konsiderueshme i përmbahen rekomandimeve të shprehura në mendimin e Komisionit të Venecias. Megjithatë, sa i përket procedurës, me dhënien e mundësisë kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të referuesve të marrin pjesë në diskutimin dhe votimin për vendimin, para Këshillit Gjyqësor hapet dilemë e arsyeshme nëse dhe në cilën masë është plotësuar rekomandimi i Komisionit të Venecias nga dhjetori i vitit 2015, sipas së cilës anëtarët ose trupat e Këshillit gjyqësor të cilët janë të përfshirë në fazën fillestare të procedurës disiplinore si “të akuzuar” ose “hetues” mos marrin pjesë në miratimin e vendimit përfundimtar.

Në praktikë edhe përpos zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Këshillit gjyqësor, në bazë të së cilës u ndryshuan komisionet për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës u vërejtën vështirësi në respektimin e parimit të urgjencës së këtyre procedurave dhe afateve për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara gjatë procedurave.

Duke e marrë parasysh periudhën relativisht të shkurtë nga kompletimi i reformave në këtë fushë, në këtë fazë është vështirësuar nxjerrja e konkluzioneve në raport me risitë e sistemit, në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mundësinë e pjesëmarrjes së publikut, transparencës, argumentimit të vendimeve, si dhe në lidhje me paanshmërinë e të gjithë procesit. Për këtë shkak, periudhën në vijim, nevojitet të rritet monitorimi mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RMV me qëllim të sigurohet sistem tërësisht funksional dhe i drejtë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave.

Pjesa 6: Ndërprerja dhe shkarkimi nga funksioni gjyqësor

6.1 Çfarë sollën reformat? -Analizë e kornizës ligjore

Në Ligjin për gjykatat, Kapitulli V i është kushtuar ndërprerjes dhe shkarkimit të gjykatësit nga funksioni dhe i rregullon dispozitat për ndërprerjen e funksionit gjyqësor, shkarkimin e gjykatësit, ushtrimin e funksionit gjyqësor në mënyrë joprofesionale dhe të pa ndërgjegjshme, ndërsa Ligji për Këshillin Gjyqësor të RMV e rregullon këtë materie në nenet prej 53 deri në 74.

Ndërprerja e funksionit gjyqësor

Sipas nenit 73 të Ligjit për gjykatat, gjykatësit i ndërpritet funksioni gjyqësor nëse:

- kërkon ai vetë,

- në mënyrë të përhershme e humb aftësinë për ushtrimin e funksionit gjyqësor, që konstaton Këshilli Gjyqësor i RMV,
- i ka plotësuar kushtet për pension të moshës, me mundësi për vazhdimin e mandatit në pajtim me dispozitat për marrëdhënie pune,
- bëhet deputet ose ushtron funksion politik në parti politike ose realizon aktivitet partiak ose politik, përveç kur funksioni gjyqësor është jashtë funksioni nën kushtet e përcaktuara e ligj, dhe
- është i dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale me dënim me burg pa kusht prej të paktën gjashtë muaj¹¹⁹.

Ligji për Këshillin gjyqësor i parashikon shkaqet e njëjta për ndërprerjen e funksionit gjyqësor si edhe Ligji për gjykatat por në mënyrë plotësuese arsyeton se si Këshilli Gjyqësor duhet të miratojë aktvendime për ndërprerjen e funksionit gjyqësor.

Në rast të ndërprerjes së funksionit gjyqësor me kërkesë të gjykatësit, Këshilli gjyqësor duhet të miratojë aktvendim pa i analizuar në mënyrë të veçantë shkaqet e kërkesës.¹²⁰

Këshilli gjyqësor RMV e aktvendim e përcakton ndërprerjen e funksionit gjyqësor të gjykatësit, për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit gjyqësor. Humbja e përhershme e aftësisë për ushtrimin e funksionit gjyqësor përcaktohet në bazë të dokumentacionit me diagnozë, vlerësim dhe mendim nga komisioni shëndetësor përkatës. Këshilli gjyqësor e ngre procedurën për konstatimin e humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit gjyqësor me detyrë zyrtare kur vetë do të sigurojë informacione të këtilla ose kur iniciativë të këtillë do të japë kryetari i gjykatës në të cilën gjykatësi ushtron funksionin ose kryetari i gjykatës më të lartë ose seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut¹²¹.

Risi e rëndësishme në ndryshimet ligjore të Ligjit për gjykatat, është mundësia për vazhdimin e mandatit të gjykatësve të cilëve deri më tani me ligj u është përcaktuar se në pension dalin në moshën 64 vjeç, por tani kanë mundësi të vazhdojnë të punojnë deri në moshën 67 vjeç, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.¹²²

Funksioni gjyqësor ndërpritet edhe kur gjykatësi është zgjedhur ose emëruar në funksione tjetër publik, përveç në rastin kur me ligj është parashikuar pushimi i funksionit gjyqësor, me ditën e zgjedhjes, përkatësisht emërimit.

Këshilli gjyqësor me aktvendim do të konstatojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës së gjykatësit, kur gjykatësi është dënuar për vepër të kryer penale me dënim me burg pa kusht prej të paktën gjashtë muaj ose i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalin për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepra në lidhje me keqpërdorimin e funksionit gjyqësor, me plotfuqishmëri të vendimit gjyqësor me të cilën është shqiptuar kjo masë, respektivisht kundërvajtje¹²³. Gjykata e cila ka miratuar vendimin e plotfuqishëm për vepër penale me dënim me burg pa kusht prej të paktën gjashtë muaj, është i obliguar menjëherë pas plotfuqishmërisë së vendimit me shkrim të njoftojë Këshillin Gjyqësor të RMV dhe kryetarin e gjykatës ku gjykatësi e ushtron funksionin gjyqësor¹²⁴.

¹¹⁹ Neni 74 i Ligjit për gjykatat.

¹²⁰ Neni 55 i Ligjit për Këshillin gjyqësor.

¹²¹ Neni 56 i Ligjit për Këshillin gjyqësor.

¹²² Raporti nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor të RMV maj – gusht 2019, Instituti për të Drejtat e Njeriut

¹²³ Neni 58 i Ligjit për Këshillin gjyqësor.

¹²⁴ ibid

Në afat prej dhjetë ditë nga dita e informimit për shkaktimin e ndonjë nga rastet e lartë përmendura, Këshilli Gjyqësor i RMV, konstaton ndërprerjen e funksionit gjyqësor me çka gjykatësit i pushon e drejta për pagë.

Shkarkimi nga funksioni gjyqësor

Në lidhje me shkarkimin e gjykatësit nga funksioni gjyqësor, sipas nenit 74, paragrafi 1 të Ligjit për gjykatat, ka dy baza mbi të cilat mund të shkarkohet gjykatës:

- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën të pa denjë për ushtrimin e funksionit gjyqësor të përcaktuar me ligj dhe
- për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pa ndërgjegjshëm të funksionit gjyqësor nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Shkelje më e rëndë disiplinore, për të cilën ngrihet procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit, konsiderohet:

- shkelje më e rëndë e rendit dhe paqes publike dhe forma të tjera më serioze të sjelljes së pa hijshme me të cilën rrënohet reputacioni i gjykatës dhe reputacioni i tij,
- ndikim ashpër dhe përzierje në ushtrimin e funksionit gjyqësor të gjykatësit tjetër,
- nëse refuzon të paraqesë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesa në pajtim me ligjin ose nëse të dhënat e përfshira në deklaratën në masë të madhe janë të pavërteta, ose
- për shkak të shkeljes evidente të rregullave për përjashtim nga situata në të cilat gjykatësi e ka ditur ose është dashur ta dijë ekzistimin e ndonjë nga bazat për përjashtim të parashikuara me ligj.¹²⁵

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykatat zvogëlohet numri i shkeljeve më të rënda disiplinore për të cilat ngrihet procedurë për shkarkimin mbi katër, për dallim nga zgjidhja e kaluar në të cilën kishte dy baza. Në mënyrë plotësuese me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për gjykatat, shlyhet alineja se bazë për shkarkimin e gjykatësit mund të jetë aktvendim gjyqësor eventual i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilin konstatohet shkelja e nenit 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo dispozitë ishte në kundërshtim me praktikën e GjEDNj dhe me praktikën ndërkombëtare për gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.¹²⁶

Me ushtrim jo profesional i pa ndërgjegjshëm i funksionit gjyqësor nënkuptohet profesionalizmi i pa kënaqshëm ose pa përgjegjshmëria e gjykatësit që ndikojnë në cilësinë dhe shpejtësinë e punës, dhe kjo nëse:

- gjatë dy vlerësimeve të njëpasnjëshme nuk i plotëson kriteret për sukses gjatë punës, për faj të gjykatësit pas shkaqe të arsyeshme, për çka është vlerësuar me dy nota negative, ndërsa në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë,
- është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim më të vogël se gjashtë muaj, ndërsa i cili është rezultat i drejtpërdrejtë i veprimit në ushtrimin e funksionit gjyqësor, me qëllim ose me pakujdesi të vetëdijshme,

¹²⁵ Neni 74 i Ligjit për gjykatat.

¹²⁶ DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN DHE PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM, Instituti për të Drejtat e Njeriut, faqe 9, e qasshme në [http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20Sudski%20sovet%20na%20RM%202018%20\(MKD\)%20web.pdf](http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20Sudski%20sovet%20na%20RM%202018%20(MKD)%20web.pdf)

- në mënyrë të paautorizuar lëshon informacione të klasifikuara, përkatësisht informacione dhe të dhëna për lëndë gjyqësore me çka shkelet obligimi për mbrojtjen e fshehtësisë së procedurës të përcaktuar me ligj dhe kur publiku është i përjashtuar në pajtim me ligj,
- pa shkak të arsyeshëm nuk i cakton seancat gjyqësore në lëndët të cilat i janë ndarë në punë ose në mënyrë tjetër e prolongon procedurën,
- nuk e merr lëndën në punë për çka shkatohet parashkrimi i ndjekjes penale ose parashkrimi i ekzekutimit të sanksionit penal për vepër penale,
- merr për punë, lëndë e cila nuk i është ndarë nëpërmjet sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndë gjyqësore në gjykatat,
- me qëllim dhe në mënyrë të pa arsyetuar bën gabim të madh profesional, gjatë çka interpretimi i ndryshëm i së drejtës dhe fakteve nuk mund të paraqesin bazë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit¹²⁷.

Në rast të formës më të butë të shkeljes së bazave nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykatësit mund ti shqiptohet masë disiplinore.

Kryetar i gjykatës shkarkohet nga funksioni kryetar kur Këshilli Gjyqësor i RMV gjatë procedurës do të konstatojë plotësimin e disa prej bazave në vijim:

- tejkalim dhe shkelje e autorizimeve ligjore,
- disponim jo ligjor dhe pa dedikim me mjetet financiare të gjykatës,
- ndikim mbi pavarësinë e gjykatësve në lidhje me vendimmarrjen për lëndë të ndryshme,
- mos zbatim të dispozitave në lidhje me menaxhimin dhe disponimin me lëndët gjyqësore,
- shkelje e dispozitave për miratim dhe ndryshim të Orarit vjetor të gjykatësve,
- nëse kryetari i gjykatës nuk e njofton Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për shkeljen më të rëndë disiplinore të kryer nga gjykatës në gjykatën në të cilën ai është kryetar, nëse shkaktimi i shkeljes është i njohur nga ai, ndërsa mos denoncimi është për shkak të fshehjes së shkeljes,
- pamundëson kryerjen e mbikëqyrjes në gjykatë në pajtim me ligjin¹²⁸.

Njëlloj si tek gjykatësit edhe te kryetarët e gjykatave, në rast të formës më të lehtë të shkeljes së bazave për shkarkim, kryetarit të gjykatës mund t'i shqiptohet masë disiplinore.

Vendimin për shkarkimin e gjykatësit e miraton Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë nëse:

- shkelja është kryer me qëllim ose pakujdesi evidente për faj të gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme, dhe
- shkelja ka shkaktuar pasoja të rënda.

Ligji për Këshillin Gjyqësor i parashikon të gjitha shkaqet për shkarkimin nga funksioni gjyqësor si edhe Ligji për gjykatat, por në mënyrë plotësuese e arsyeton procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit.

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës

Edhe pse risitë në procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës janë përpunuar në detaje në pjesën 5 të kësaj analize, në këtë pjesë do ta

¹²⁷ Neni 76 ibid

¹²⁸ Neni 79 ibid

paraqesim rrjedhën e procedurës për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës që rezulton me shkarkim, në pajtim me zgjidhjet e reja ligjore.

Sipas nenit 61 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, procedura për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës iniciohet në afat prej gjashtë muaj nga dita e informimit për kryerjen e shkeljes, por jo më vonë se tre vjet nga dita e kryerjes së shkeljes. Ajo është urgjente dhe me karakter të konfidencial, mbahet pa prezencën e publikut dhe me respektimin e reputacionit dhe dinjitetit të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës gjatë çka mbahet llogari për mbrojtjen e të dhënave personale të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Me kërkesë të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, këshilli do të vendosë procedura të jetë publike dhe në të mund të marrë pjesë edhe përfaqësues i Shoqatës së gjykatësve.

Zgjidhjet e reja ligjore japin mundësi, kërkesë për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit ose kryetar të gjykatës të paraqesë cili do person, për dallim nga zgjidhja e mëparshme sipas së cilës kërkesën mund ta paraqesë anëtar i Këshillit Gjyqësor, kryetar i gjykatës, kryetar i gjykatës më të lartë ose seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme.

Kërkesa e arsyetuar për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës dorëzohet te Këshilli dhe përmban: emër dhe mbiemër të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, adresën dhe vendin e banimit, në cilën gjykatë e ushtron funksionin, përshkrim të shkeljes, emri ligjor i shkeljes me përmendjen e dispozitave të Ligjit për gjykatat dhe propozim - dëshmi që duhet të paraqiten gjatë diskutimit.¹²⁹

Pas marrjes së kërkesës për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, Këshilli i anëtarëve me të drejtë vote me anë të tërheqjes së shortit formon Komision të referuesve të përbërë nga tre anëtarë nga të cilët dy janë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga gjykatësit ndërsa një nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kur Këshilli përcakton përgjegjësi të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, i cili i takon bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Komisionin një anëtar duhet të jetë pjesëtar i bashkësisë e cila nuk është shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kryetari i Komisionit zgjidhet me short nga radhët e anëtarëve të Komisionit.

Nëse Komisioni , nuk e refuzon kërkesën për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit, respektivisht të kryetarit të gjykatës si jo të arritur në kohë, jo të plotë ose të pa bazuar, do t'i dërgojë njoftim për gjendjen faktike të konstatuar, të Këshillit Gjyqësor i cili është i obliguar të vendosë në afat prej shtatë ditë nga dita e dorëzimit të njoftimit për ndërprerjen ose vazhdimin e procedurës.

Në rastet kur Këshilli gjyqësor do të vendosë për vazhdimin e procedurës, Komisioni është i obliguar të grumbullojë të gjitha informacionet e nevojshme dhe të hartojë raport në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

Komisioni cakton diskutim në afat prej shtatë ditë nga dita e marrjes së përgjigjes e kërkesë të gjykatës ose kryetarit të gjykatës. Komisioni punon në përbërje të plotë dhe me të

¹²⁹ Neni 62 i Ligjit për Këshillin gjyqësor tw RMV

udhëheq kryetari¹³⁰. Komisioni në afat prej 15 ditë nga dita e përfundimit të diskutimit paraqet raport për gjendjen e konstatuar me kërkesë të Këshillit.¹³¹

Më pas vijon diskutimi në Këshillin Gjyqësor të RMV në të cilin kryetari i Komisionit e arsyeton raportin.¹³² Gjatë vendimmarrjes në lidhje me raportin, Këshilli përkohësisht mund të largojë gjykatësin ose kryetarin e gjykatës nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në pajtim me Ligjin për gjykatat. Pas përfundimit të diskutimit, Këshilli Gjyqësor fillimisht vendos për ndërprerjen e procedurës nëse konstaton se nuk ka bazë për përgjegjësi, me të paktën shtatë vota nga numri i përgjithshëm me të drejtë vote.¹³³

Kur Këshilli Gjyqësor nuk do të marrë vendim për ndërprerjen e procedurës, respektivisht konstaton se gjykatësi ose kryetari i gjykatës ka kryer shkelje më të rëndë disiplinore ose në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme e ka ushtruar funksionin gjyqësor, nën kushtet e përcaktuara me ligj, vendos për shkarkimin e gjykatësit ose kryetarin e gjykatës me të paktën tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote. Me miratimin e vendimit për shkarkim, gjykatësi ose kryetari i gjykatës përkohësisht largohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor, përkatësisht kryetar i gjykatës deri në pritjen e përfundimit efektiv të procedurës.

Ekziston mundësi Këshilli gjyqësor gjatë diskutimit për raportin e Komisionit të vlerësoje se nevojitet përpunim plotësues i lëndës, dokumentet e lëndës mund t'i kthejë te Komisioni në përpunim plotësues më së shumti njëherë, dhe Komisioni është i obliguar t'i përpunojë dhe përsëri t'ia dorëzojë Këshillit Gjyqësor në afat prej 15 ditë.¹³⁴

Nëse gjykatësi, përkatësisht kryetari i gjykatës kundër të cilit është iniciuar procedura për përcaktimin e përgjegjësisë gjatë procedurës paraqet kërkesë për ndërprerjen e funksionit gjyqësor, Këshilli Gjyqësor do të konstatojë pushimin e funksionit gjyqësor dhe do të vazhdojë procedurën deri në marrjen përfundimtare të vendimit që do të jetë pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore të gjykatësit, përkatësisht kryetarit të gjykatës¹³⁵. Me këtë dispozitë rritet shkalla e përgjegjësisë së gjykatësit dhe mundësia për kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj palëve.

Gjykatësi përkatësisht kryetari i gjykatës për të cilin është iniciuar procedura për përcaktimin e përgjegjësisë ka të drejtë për ankesë në Këshillin për Vendimmarrje për Ankesa pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të vendimit. Këshilli për ankesën mund ta konfirmojë ose ta anulojë aktvendimin e Këshillit në rast të shkeljes së rëndë të dispozitës për procedurën për përgjegjësi të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës. Nëse Këshilli për ankesa e abrogon aktvendimin, Këshilli do ta përsëritë procedurën, detyrimisht duke i respektuar udhëzimet e Këshillit për ankesa, do të marrë vendim dhe publikisht do ta paraqesë këtë në ueb faqen e vet. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë as padi.¹³⁶

Gjykatësi ose kryetari i gjykatës e drejta e të cilit është shkelur gjatë procedurës ka të drejtë të përsërisë procedurën me qëllim vendim përfundimtar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg nëse paraqet kërkesë për përsëritjen e procedurës te Këshilli

¹³⁰ Neni 66 paragrafi 1 ibid

¹³¹ Neni 67 paragrafi 1 ibid

¹³² Neni 68 paragrafi 1 ibid

¹³³ Neni 69 paragrafi 1 ibid

¹³⁴ Neni 70 ibid

¹³⁵ Neni 68 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit për Këshillin gjyqësor

¹³⁶ Neni 72 ibid

Gjyqësor në afat prej 30 ditë, por jo më vonë se tre vjet nga përfundimi i aktvendimit gjyqësor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹³⁷

6.2 Aplikimi i risive

Pas miratimit të Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat deri në botimin e kësaj analize, janë marrë vendime për ndërprerjen e funksionit gjyqësor për 5 gjykatës për shkak të plotësimit të kushtit për pension të moshës dhe me kërkesë për ndërprerje të funksionit gjyqësor.

Gjatë kësaj periudhe nuk janë marrë vendime për shkarkimin e gjykatësve.

Sa i përket risisë në ndryshimet ligjore të Ligjit për gjykatat për mundësinë për vazhdimin e mandatit të gjykatësve të cilëve deri më tani me ligj u është përcaktuar se në pension dalin në moshën 64 vjeç, por tani kanë mundësi të vazhdojnë të punojnë deri në moshën 67 vjeç, njëzetë gjykatësve të cilët në kohë kanë paraqitur deklaratë për vazhdimin e mandatit i njëjti u është vazhदार edhe për një vit.¹³⁸

6.3 Konkluzione

Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor të RMV dhe Ligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat vendosin disa risi esenciale në lidhje me ndërprerjen dhe shkarkimin nga funksioni gjyqësor.

Në lidhje me ndërprerjen e funksionit gjyqësor, ndryshim i konsiderueshëm ligjor është prolongimi i ndërprerjes së funksionit gjyqësor dhe mundësia për vazhdimin e mandatit të gjykatësve të cilëve deri më tani me ligj u është përcaktuar se në pension dalin në moshën 64 vjeç, por tani kanë mundësi të vazhdojnë të punojnë deri në 67 vjet, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Në mënyrë plotësuese gjykatësit i jepet mundësi mos i ndërpritet funksioni gjyqësor nëse bëhet deputet, përkatësisht anëtar i këshillit të komunës, përkatësisht Qytetit Shkup ose ka ndonjë funksion në organet shtetërore, komunë dhe qytet ose parti politike ose funksion partiak nëse funksioni gjyqësor i pushon nën kushtet e përcaktuara me ligj. Me këtë dispozitë lehtësohet mundësia gjykatësi funksioni i të cilit ka pushuar edhe pas angazhimit politik të vazhdojë me shpërndarjen e drejtësisë që është në konflikt me ndarjen e pushteteve.

Me risitë janë saktësuar bazat për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit dhe është bërë kufizim i detajuar cilat nga këto baza çojnë drejt shkarkimit të gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës, ndërsa cilat rezultojnë me shqiptimin e masës më të lehtë ose më të rëndë disiplinore respektivisht bëhet shkallëzimi i bazave për shkarkim përkatësisht do ti shqiptohet masë disiplinore dhe nuk do të shkarkohet. Procedura për veprimin mbi këto baza nga Këshilli gjyqësor në detaje është përpunuar në Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor.

Në mënyrë plotësuese, zgjidhjet e reja ligjore edhe përpos plotësimit të bazave për shkarkim i marrin parasysh edhe peshën e shkeljes së kryer dhe fajin e gjykatësit, respektivisht

¹³⁷ Neni 73 ibid

¹³⁸ Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor të RMV, Raporti numër 4 (periudha e raportimit: Maj – gusht, 2019) Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2019, i qasshëm në [http://ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/IHR%20-%20Monitoring%204-2019%20\(web\).pdf](http://ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/IHR%20-%20Monitoring%204-2019%20(web).pdf)

bëhet distinkcion nëse shkelja është kryer me qëllim ose nga pakujdesia evidente për faj të gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme dhe shkelja ka shkaktuar pasoja të vështira. Me ndryshimet zvogëlohet numri i shkeljeve më të rënda disiplinore për të cilat ngrihet procedurë për shkarkim përkatës, për dallim nga zgjidhjet e kaluara në të cilat kishte nëntë baza.

Këto ndryshime paraqesin hapa pozitiv në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit dhe përgjegjësisë së gjykatësve edhe pse nevojitet edhe monitorimi i mëtutjeshëm si nga aspekti i përmbajtjes ashtu edhe nga aspekti i zbatimit.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2019 u miratuan ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykatat¹³⁹ dhe Ligjin për akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik¹⁴⁰ si dhe Ligjin tërësisht të ri për Këshillin Gjyqësor¹⁴¹ me qëllim sigurimin e kushteve të cilat do të garantojnë pavarësi esenciale në gjykatat si institucione të pushtetit gjyqësor, por edhe pavarësi individuale, paanshmëri, cilësi, profesionalizim dhe efikasitet të gjykatave.

Në vitin 2018, u miratua Ligji i ri për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publik¹⁴² qëllimi i së cilit ishte të adresohen mangësi të caktuara në lidhje me organet menaxhere dhe udhëheqëse, ndërsa në mënyrë plotësuese u bënë ndryshime në kriteret për pranimin e studentëve të Akademisë. Anulimi i mesatares së nevojshme të kandidatëve nga të paktën 8,0 e cila në masë të madhe i kufizonte kandidatët potencialë për pranim, ishte risia kryesore si rezultat i këtij ligji.

Në korrik të vitit 2019 në Kuvendin e RMV u paraqit propozim ligji i ri për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publik me të cilin bëhet harmonizimi në udhëzimet e përfshira në Strategjinë për reforma në sektorin e drejtësisë dhe rekomandimet e dhëna nga institucione relevante ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i Ligjit është rishikimi i mënyrës së seleksionimit dhe dhënies së provimit pranues dhe provimit përfundimtar para komisionit profesional, në bazë të kriterëve matëse dhe objektive për vlerësimin e dijes së kandidatëve. Pjesë më e madhe e ndryshimeve kanë të bëjnë me dhënien e provimit pranues dhe provimit përfundimtar në Akademi, si dhe dhënien e provimit për çdo modul në fazat e para të trajnimit fillestar.

Gjatë periudhës raportuese nga aktivitetet e Akademisë së gjykatësve dhe prokurorëve publik mund të konkludohet se Akademia ka deficit të hapësirave, kapacitete financiare dhe burime njerëzore dhe reformat në këtë drejtim janë më tepër se të nevojshme. Edhe pse janë kërkuar gjithsej 120 gjykatës të rinj dhe prokurorë publik nga Këshilli gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publik, Akademia e Gjykatësve dhe prokurorëve publik ka mundur kapacitet për vetëm 60 studentë për shkak të mungesës së kushteve hapësinore.¹⁴³

Kapacitetet përkatëse të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik janë me rëndësi esenciale duke pasur parasysh se përfundimi i trajnimit të Akademisë për gjykatësve dhe prokurorë publik bëhet mënyra e vetme për fillimin e karrierës gjyqësore, përkatësisht gjykatësit e gjykatës themelore do të zgjedhin vetëm nga lista e kandidatëve që janë paraqitur në konkurs, të dorëzuar nga Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik deri te Këshilli gjyqësor i RMV.

Sa i përket procesit të zgjedhjes së gjykatësve në gjykatat themelore ndryshime më të rëndësishme në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV dhe Ligjin për gjykatat, gjykatat themelore të cilat ndikojnë në cilësinë e gjyqësorit me atë që për herë të parë Këshilli Gjyqësor gjatë zgjedhjes së gjykatësve në gjykatën themelore, do të realizojë intervistë me

¹³⁹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat "Gazeta Zyrtare e RMV nr. 83/2018, 198/2018, 96/2019.

¹⁴⁰ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve publik Gazeta Zyrtare e RMV nr. 163/2018.

¹⁴¹ Ligji për Këshillin gjyqësor të RMV, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 102/2019.

¹⁴² Собрание на Република Македонија, 'Седница број 58 на Собрание на Р. Македонија закажана на 29.08.2018' (29 August 2018) <<https://www.sobranie.mk/sessiondetails.nsp?sessionDetailsId=5f30c475-2ee9-4cac-9859-e9ec6841570f&date=29.8.2018>> accessed 16 October 2019.

¹⁴³ nezavisen.mk (neni 17).

kandidatët, që do të përcaktojnë 10% të pikëve të cilat i fiton kandidati. Kjo e ndryshon funksionin e Këshillit Gjyqësor gjatë zgjedhjes së gjykatësve, nga emërimi formal i zgjedhjes esenciale të gjykatësve. Gjatë zgjedhjes së gjykatësit, Këshilli Gjyqësor do t'i marrë parasysh vitin e përfundimit të trajnimit dhe suksesin e arritur, si dhe rezultatet e intervistës.

Në mënyrë plotësuese vendoset mundësia për ankesë për kandidatin i cili nuk është zgjedhur gjykatës, i cili në afat prej tetë ditë nga pranimi i njoftimit ka të drejtë të përdorë këtë mjet juridik për të cilin vendos Këshilli për Ankesa pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka mundësohet llogaridhënia e Këshillit Gjyqësor dhe efikasitet më i madh i Gjykatës Supreme gjatë zgjedhjes së gjykatësve.

Në lidhje me zgjedhjen e gjykatësve të Gjykatës Administrative, janë rreptësuar kriteret për zgjedhjen e gjykatësit për çka edhe në këtë gjykatë do të zgjidhet vetëm gjykatës i cili ka kryer trajnimin në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publik dhe ka përvojë pune prej të paktën katër vjet stazh të pa ndërprerë në gjyqësor si gjyqtar në gjykatën themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili nga Këshilli Gjyqësor është vlerësuar me notë pozitive. Me këtë largohet zgjidhja e kaluar ligjore e cila parashikonte se për gjyqtar të Gjykatës Administrative mund të zgjidhen edhe persona të cilët kanë të paktën pesë vjet stazh pune në çështje juridike në organ shtetëror, me rezultate të konfirmuara në punë.

Risi është ajo që personi i cili të paktën një mandat ka qenë gjykatës dhe i cili i plotëson kushtet, mund të zgjidhet gjykatës në gjykatat e të gjitha shkallëve.

Gjatë periudhës raportuese, është bërë zgjedhja e një gjykatësi në Gjykatën supreme nga fusha penale, tetë kryetarë të gjykatave themelore dhe dy gjykatës në Gjykatën Administrative. Duke e pasur parasysh se konkurset për këto zgjedhje janë publikuar para ndryshimeve të reja ligjore, zgjedhjet në fjalë janë bërë sipas kriterëve paraprake dhe procedurës së zgjedhjes.

Me ligjet e reja është bërë rreptësimi i kriterëve në lidhje me zgjedhjen e gjykatësve në gjykatat themelore dhe Gjykatën Administrative. Cilësia, efektiviteti dhe efikasiteti i kornizës së re ligjore, për zgjedhjen e gjykatësve në gjykatat themelore dhe Gjykatën Administrative, do të shihen kur do të fillojë zbatimi i tyre praktik dhe kur do të bëhet zgjedhja e gjykatësve sipas zgjedhjeve të reja ligjore.

Në lidhje me vlerësimin e gjykatësve, ligji parasheh kornizë solide për përmirësimin e sistemit të vlerësimit të punës së gjykatësve, me atë që parashikon prioritete të cilësisë përkundër kriterëve kuantitative. Qasja e këtillë e vlerësimit mundëson përforsimin përkatës të zhvillimit profesional dhe avancimin e gjykatësve me vetë atë që për herë të parë në esencë në fokus e vendos cilësisë e drejtësisë gjyqësore nëpërmjet vlerësimit të argumentimit dhe kuptimit të vendimeve.

Kriteret për vlerësimin e cilësisë së procedurës gjyqësore dhe punën e gjykatësit nëpërmjet përfshirjes së gjykatësve të cilët e bëjnë vlerësimin, siguron vlerësimin objektiv në punën e gjykatave.

Megjithatë puna e Komisionit e përbërë nga gjykatës të gjykatave më të larta dhe Komisioni nga anëtarë të Këshillit Gjyqësor duhet të rregullohet me detaje me Metodologjinë në të cilën do të përfshihen më shumë aspekte të vlerësimit të cilësisë.

Para zbatimit të plotë të sistemit të ri të vlerësimit, duhet Këshilli gjyqësor të ndryshojë Metodologjinë me indikatorë për kompleksitetin e lëndëve nga e cila në tërësi varet veprimi i gjykatësve.

Duhet të vendoset sistem i ri për përcaktimin e normës për orientim e cila do të bazohet në specifikën dhe kompleksitetin e lëndëve për secilën gjykatë në veçanti, fushat juridike dhe kompetencën reale të gjykatës, duke pasur kujdes ndër të tjerat të mos ndikojë mbi vëllimin dhe cilësinë e veprimit të gjykatësve.

Një nga qëllimet kryesore të reformave më të reja gjyqësore ishte veprimi në lidhje me ankesat në raport me ri përkufizimin e kushteve për zgjedhjen e gjykatësit në gjykatë më të lartë, përkatësisht rregullimin e mënyrës së zgjedhjes së gjykatësit në gjykatë më të lartë dhe përcaktimin e sistemit të vlerësimit të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, aspekte të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë. Zgjidhjet e reja ligjore përpos stazhit të përcaktuar për gjykatësin në gjykata më të larta dhe për kryetarin e gjykatës, detyrimisht e përcaktojnë edhe vlerësimin e gjykatësit me notë pozitive nga Këshilli Gjyqësor. Përfundimisht saktësohen kriteret mbi të cilat vlerësohen gjykatësit gjatë avancimit të tyre dhe i është dhënë përparësi e madhe cilësisë së kriterëve në raport me kriteret kuantitative.

Edhe pse nga hyrja në fuqi e zgjidhjeve të reja ligjore ishte bërë zgjedhja e gjykatësve në gjykata më të larta dhe kryetarë të gjykatave, kjo zgjedhje u krye në bazë të ligjit të kaluar për shkak se konkurset u publikuan para hyrjes në fuqi të ligjeve të reja.

Si edhe pas zgjedhjes së gjykatave në gjykata themelore, ligjet e reja i përforcojnë kriteret për zgjedhjen e gjykatësve në gjykata më të larta dhe kryetarë të gjykatave që duhet të kontribuojë për zgjedhje më cilësore dhe më objektive. Megjithatë, duhet praktikisht të zbatohen kriteret e reja për zgjedhje dhe mënyra e re për vlerësim që të përcaktohet shkalla e harmonizimit dhe nevoja për rishikim.

Në lidhje me përgjegjësinë e gjykatësve, intervenimet e shpeshta në rregullat esenciale të cilat i rregullojnë bazat dhe procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësve sipas rregullit nuk kontribuojnë drejt përforcimit të sigurisë juridike.

Ndryshimet dhe plotësimet e miratuara në lidhje me bazat për përgjegjësi në masë të konsiderueshme respektojnë rekomandimet e paraqitura në mendimin e Komisionit të Venecias, por imponohet dilema nëse dhe në çfarë mase është plotësuar rekomandimi i Komisionit të Venecias nga dhjetori i vitit 2015 sipas së cilës anëtarët ose trupat e Këshillit gjyqësor të përfshirë në fazën fillestare të procedurës disiplinore si “prokurorë” ose “hetues” mos marrin pjesë në vendimin final. Në praktikë vërehen vështirësi në respektimin e parimit të urgjencës të këtyre procedurave dhe afateve për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara gjatë procedurave.

Duke e pasur parasysh dinamikën e reformave në këtë fushë, është i shpejtuar konkluzioni në lidhje me risitë në sistem, në veçanti ato për mundësinë e pjesëmarrjes së publikut, transparencën dhe paanshmërinë e gjithë procesit. Në këtë drejtim, nevojitet monitorim i zmadhuar mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RMV me qëllim të sigurojë sistem të plotë funksional dhe të drejtë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave.

Ligji i ri për Këshillin gjyqësor të RMV dhe Ligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat vendosin disa risi të reja në raport me ndërprerjen dhe shkarkimin nga funksioni gjyqësor.

Në lidhje me ndërprerjen e funksionit gjyqësor, ndryshim i konsiderueshëm ligjor është prolongimi i ndërprerjes së funksionit gjyqësor dhe mundësia për vazhdimin e mandatit të gjykatësve të cilëve deri më tani me ligj ju është përcaktuar se në pension

dalim në moshën 64 vjet, por tani kanë mundësi të vazhdojnë me punë deri në moshën 67 vjet, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Diskutabile është edhe risia e re ligjore për pezullimin e funksionit gjyqësor gjatë angazhimit politik pas ndërprerjes së të cilit mund të vazhdohet me punë, që është në konflikt me ndarjen e pushteteve.

Me risitë saktësohen bazat për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit dhe është bërë përkufizim i detajuar i cilat nga këto bazat rezultojnë me shkarkimin e gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës, ndërsa cila me shqiptimin e masës më të lehtë ose më të rëndë disiplinore, përkatësisht bëhet shkallëzimi i bazave për shkarkim. Kështu, nëse gjykatësi ose kryetari i gjykatës kryen formë më të lehtë të shkeljes së bazave, mund të shqiptohet masë disiplinore dhe nuk do të shkarkohet. Ligji më i ri për Këshillin Gjyqësor, në detaje i përpunon hapat për veprim mbi këto baza.

Zgjidhjet e reja ligjore parashikojnë edhe përpos plotësimit të kushteve për shkarkim, të merren parasysh edhe pesha e shkeljes së kryer dhe fajti i gjykatësit, përkatësisht qëllimi i tij ose pakujdesia. Në mënyrë plotësuese, me ndryshimet reduktohet numri i shkeljeve më të rënda disiplinore për të cilat ngrihet procedura për shkarkimin mbi katër, për dallim nga zgjidhjet e mëparshme në të cilat kishte nëntë baza.

Këto ndryshime paraqesin hap pozitiv në drejtim të rritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjësisë së gjykatësve, edhe pse duhet edhe monitorimi i mëtutjeshëm si nga aspekti i përmbajtjes, ashtu edhe nga aspekti i zbatimit.

ANEKSI I

Totali qershor – tetor, 2019	Zgjedhje	Ndërprerje	Shkarkim	Vazhdim i mandatit
Qershor, 2019	/	/	/	Vazhdim i mandatit të pesë gjykatëse
Korrik, 2019	/	Ndërprerje e funksionit të një gjykatësi për shkak të plotësimit të kushteve për pension të moshës	/	Vazhdimi i mandatit të tre gjykatësve
Gusht, 2019	/	/	/	Vazhdim i mandatit të gjashtë gjykatëse
Shtator, 2019	Zgjedhja e një gjykatësi të Gjykatës Supreme nga fusha penale	/	Dy shkarkime – është përcaktuar përgjegjësia e një kryetari të gjykatës dhe një gjykatësi (Pas diskutimit për Raportin e Komisionit për Përcaktimin e Përgjegjësisë së gjykatësit / kryetarit të gjykatës janë marrë vendime me çka një kryetar i gjykatës është shkarkuar funksioni kryetar i gjykatës dhe një gjykatës është shkarkuar nga ushtrimi i funksionit gjyqësor)	Vazhdim i mandatit të gjashtë gjykatëse
Tetor, 2019	Zgjedhje e tetë kryetarëve të gjykatave themelore, Zgjedhje e kryetarit të Gjykatës së Lartë Administrative, Vendim për zgjedhjen e dy gjykatësve të Gjykatës Administrative	/	/	/

LITERATURA E PËRDORUR

1. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 83/2018, 198/2018, 96/2019
2. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publik, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 163/2018
3. Ligji për Këshillin gjyqësor të RMV "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019
4. Analizë për zbatimin e strategjisë për reformë të sektorit gjyqësor (2017 - 2022) për periudhën 2018/2019
5. Propozim ligj për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publike të dorëzuar në qershor 2019, në Kuvendin e RMV
6. Raport në hije Kapitulli 23 për periudhën qershor 2018 – mars 2019
7. Analizë funksionale për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publik, Shkup, nëntor 2019
8. Ligji për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)
9. Ligji për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)
10. Ligji për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)
11. Raport nga monitorimi i punës së Këshillit gjyqësor të RMV
12. North Macedonia opinion on the draft law on the judicial council. Adopted by the Venice Commission at its 118th Plenary Session (Venice, 15-16 March 2019)
13. Rregullore për punën e Këshillit Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 60/06, 150/10, 100/11, 20/15, 61/15)
14. Raporti vjetor mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017
15. Raport nga monitorimi i punës së Këshillit gjyqësor të RMV, Raport numër 4 (periudha e raportimit: maj – gusht 2019)
16. Dokument për politikën publike në lidhje me organizimin dhe punën e këshillit gjyqësor të RM

